

SEE CAO

Rregullat për Alokimin në Hije (“Shadow”)

Versioni 1.0



**Podgoricë, Mal i Zi
Qershor, 2023**

Përmbajtja

Tabela e përmbajtjes

Përmbajtja.....	2
KAPITULLI 1	5
<i>Lënda dhe fushëveprimi</i>	<i>5</i>
<i>Përkufizimet dhe interpretimi.....</i>	<i>5</i>
<i>Platforma e Alokimit.....</i>	<i>8</i>
<i>Data e hyrjes në fuqi dhe aplikimi</i>	<i>9</i>
KAPITULLI 2	10
<i>Dispozita e përgjithshme.....</i>	<i>10</i>
<i>Lidhja e Marrëveshjes për Pjesëmarrje</i>	<i>10</i>
<i>Formulari dhe përmbajtja e Marrëveshjes për Pjesëmarrje</i>	<i>11</i>
<i>Dorëzimi i informatave</i>	<i>11</i>
<i>Garancitë.....</i>	<i>13</i>
<i>Llogaria e Dedikuar e Biznesit.....</i>	<i>13</i>
<i>Pranimi i Rregullave të Sistemit të Informacionit.....</i>	<i>13</i>
<i>Kostot që lidhen me Marrëveshjen për Pjesëmarrje.....</i>	<i>13</i>
<i>Refuzimi i aplikacionit</i>	<i>13</i>
<i>Qasja në Mjetin e Ankandit.....</i>	<i>14</i>
<i>Dakordimi për kushtet financiare shtesë.....</i>	<i>14</i>
<i>Kërkesat rregullatore dhe ligjore</i>	<i>14</i>
KAPITULLI 3	16
<i>Dispozitat e përgjithshme.....</i>	<i>16</i>
<i>Forma e depozitës në para të gatshme.....</i>	<i>16</i>
<i>Formulari i Garancise Bankare.....</i>	<i>17</i>
<i>Vlefshmëria dhe rinovimi i Garancisë Bankare</i>	<i>18</i>
<i>Limiti i kreditit.....</i>	<i>18</i>
<i>Modifikimet e kolateraleve</i>	<i>19</i>
<i>Incident i kolateralit.....</i>	<i>19</i>
<i>Thirrjet në kolaterale.....</i>	<i>20</i>
KAPITULLI 4	21
<i>Dispozitat e përgjithshme për ankandet në hije</i>	<i>21</i>

<i>Procesi i ankandit “Shadow” (në hije)</i>	21
<i>Specifikimi i ankandit</i>	22
<i>Dorëzimi i ofertave</i>	22
<i>Regjistrimi i ofertës</i>	23
<i>Oferta e paracaktuar</i>	23
<i>Oferta e paracaktuar për ankandin rezervë (fallback auction)</i>	24
<i>Verifikimi i limitit të kredisë</i>	24
<i>Përcaktimi i rezultateve të ankandit “Shadow”</i>	25
<i>Njoftimi i rezultateve të ankandit “Shadow”</i>	26
KAPITULLI 5	29
<i>Parimet e përgjithshme</i>	29
<i>Nominimi i të drejtave të transmetimit fizik</i>	29
<i>Dokumenti i të Drejtave</i>	29
<i>Rezervimi i të drejtave të transmetimit fizik për shërbimet e balancimit</i>	30
KAPITULLI 6	31
<i>Dispozitat e përgjithshme</i>	31
<i>Procedura rezervë për shkëmbimin e të dhënave</i>	31
<i>Procedura e tërheqjes për ankandin “Shadow”</i>	32
<i>Ankandi rezervë</i>	33
<i>Anulimi i ankandit “Shadow” (hije)</i>	33
KAPITULLI 7	35
<i>Ngjarjet aktivizuese dhe pasojat e kufizimit të të Drejtave të Transmetimit Ditor</i>	35
<i>Procesi dhe njoftimi i kufizimit</i>	35
KAPITULLI 8	36
<i>Parimet e përgjithshme</i>	36
<i>Llogaritja e shumave të papaguara</i>	36
<i>Taksat bruto</i>	36
<i>Faturimi dhe kushtet e pagesës</i>	37
<i>Mosmarrëveshjet mbi pagesën</i>	38
<i>Pagesë me vonesë dhe incident pagese</i>	39
KAPITULLI 9	40
<i>Kohëzgjatja dhe amendamenti i rregullave të alokimit “Shadow”</i>	40
<i>Përgjegjësia</i>	41

<i>Zgjidhja e mosmarrëveshjeve</i>	<i>42</i>
<i>Pezullimi i Marrëveshjes për Pjesëmarrje.....</i>	<i>43</i>
<i>Ndërprerja e Marrëveshjes për Pjesëmarrje.....</i>	<i>44</i>
<i>Forca Madhore.....</i>	<i>45</i>
<i>Njoftimet</i>	<i>46</i>
<i>Konfidencialiteti</i>	<i>48</i>
<i>Caktimi dhe nënkontraktimi</i>	<i>49</i>
<i>Ligji qeverisës.....</i>	<i>49</i>
<i>Gjuhe.....</i>	<i>49</i>
<i>Pronësia intelektuale</i>	<i>49</i>
<i>Marrëdhëniet e Palëve.....</i>	<i>50</i>
<i>Nuk ka të drejta të palëve të treta.....</i>	<i>50</i>
<i>Heqja dorë</i>	<i>50</i>
<i>Marrëveshja e plotë.....</i>	<i>50</i>
<i>Mjetet juridike ekskluzive.....</i>	<i>52</i>
<i>Vlefshmëria e pjesshme (severabiliteti)</i>	<i>52</i>
Shtojca 1	53

KAPITULLI 1

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Lënda dhe fushëveprimi

1. Në rast se bashkimi i tregut një ditë para (ang. *“day ahead market”*) nuk është në gjendje të prodhojë rezultate, krijohet një procedurë rezervë (ang. *“fallback procedure”*). Procedura rezervë për alokimin e Kapacitetit Ndërzonal në kornizën kohore të tregut një ditë përpara është një alokim i qartë në formën e të Drejtave të Transmetimit Fizik (PTR) të energjisë elektrike në baza ditore.
2. Këto Rregulla për Alokimin *“Shadow”* përmbajnë termat dhe kushtet për alokimin e të Drejtave Ditore të Transmetimit, në kufijtë e listuar në Shtojcën 1, si procedurë rezervë për bashkimin e tregut një ditë përpara, duke u kuptuar që Pjesëmarrësi i Regjistruar do të aderohet në këto rregulla nga nënshkrimi i Marrëveshjes për Pjesëmarrje. Në veçanti, Rregullat për Alokimin *“Shadow”* përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e Pjesëmarrësve të Regjistruar si dhe kërkesat për pjesëmarrje në Ankandet *“Shadow”*, ato përshkruajnë procesin e Ankandit *“Shadow”*, duke përfshirë përcaktimin e Çmimit Margjinal si rezultat i Ankandit *“Shadow”* dhe faturimin/pagesën.
3. Procedura rezervë i referohet vetëm Kapacitetit Ndërzonal dhe Pjesëmarrësit e Regjistruar nuk mund të kërkojnë asnjë të drejtë tjetër në lidhje me të Drejtat Fizike të Transmetimit që u janë alokuar atyre përveç të drejtave në përputhje me dispozitat e këtyre Rregullave për Alokimin *“Shadow”*.
4. Është e ditur se operacionet e Platformës së Alokimit mbulojnë zonën ku operojnë OST-të e Bashkimit Evropian, operatorët e sistemit të transmetimit nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe operatorët e sistemit të transmetimit nga vende të tjera. Referencat për (a) OST ose Operatorin e Sistemit të Transmetimit përfshijnë referenca ndaj OST-ve të BE-së, operatorëve të sistemit të transmetimit nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë si dhe operatorëve të sistemit të transmetimit nga këto vende të tjera, dhe (b) Autoritetet Rregullatore Kombëtare ose NRA-të përfshijnë referenca ndaj NRA-ve të BE-së dhe autoriteteve kombëtare rregullatore përkatëse në palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe vende të tjera përkatëse.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimi

1. Termat me shkronja të mëdha të përdorura në këto Rregulla për Alokimin *“Shadow”* do të kenë kuptimin që u jepet në nenin 2 të Rregullores (BE) 2019/943, nenin 2 të Rregullores (KE) 2013/543, nenin 2 të Rregullores (BE) 2015/1222, nenin 2 të Direktivës (BE) 2019/944, nenin 2 të Direktivës 2009/72/KE dhe në Rregulloren (BE) 2016/1719.
2. Përveç kësaj, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

Filial do të thotë, në lidhje me çdo person, çdo person tjetër që direkt ose indirekt kontrollon, kontrollohet ose është nën kontroll të përbashkët të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me atë person siç përcaktohet në Rregulloren e BE-së (KE) Nr. 139/2004 e datës 20 janar 2004 mbi

kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve ose, siç mund të jetë, legjislacionin e ngjashëm kombëtar;

Platforma e Alokimit do të thotë një entitet i emëruar dhe i autorizuar nga Operatori (operatorët) përgjegjës i Sistemit të Transmetimit për të vepruar në emër të tyre dhe në emër të vet, duke qenë një platformë e vetme alokimi ose platformë (platforma) rajonale për atribimin e Kapacitetit Ndërzonal ditore përmes Ankandeve “Shadow” , siç përcaktohet në Marrëveshjen për Pjesëmarrje;

Mjeti i Ankandit nënkupton sistemin e teknologjisë së informacionit që përdoret nga Platforma e Alokimit për të kryer ankande dhe për t'i lehtësuar procedurat e tjera të përshkruara në këto Rregulla për Alokimin “Shadow”;

Specifikimi i Ankandit nënkupton një listë të karakteristikave specifike të një Ankandi të veçantë “Shadow” , duke përfshirë natyrën e produkteve të ofruara dhe datat përkatëse;

Garancia Bankare nënkupton një letër kredie të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme të gatishmërisë ose letër garancie të lëshuar nga një bankë;

Oferta nënkupton një çift të Sasisë së Ofertës dhe Çmimit të Ofertës të ofruar nga një Pjesëmarrës i Regjistruar që merr pjesë në një ankand;

Çmimi i Ofertës nënkupton çmimin që një pjesëmarrës i regjistruar është i gatshëm të paguajë për një (1) MË dhe orë të të Drejtave Ditore të Transmetimit;

Sasia e Ofertës nënkupton sasinë e të Drejtave Ditore të Transmetimit në MË të kërkuar nga një Pjesëmarrës i Regjistruar;

Periudha e Ofertimit nënkupton periudhën kohore brenda së cilës Pjesëmarrësit e Regjistruar që dëshirojnë të marrin pjesë në një ankand mund të dorëzojnë ofertat e tyre;

Llogaria e Biznesit nënkupton një llogari të dedikuar depozite të hapur nga Platforma e Alokimit me qëllim të sigurimit të kolateraleve në formën e depozitave në para të gatshme nga Pjesëmarrësit e Regjistruar, të cilat mund të përdoren për pagesa nga Pjesëmarrësi i Regjistruar;

Identifikimi i Marrëveshjes së Kapacitetit (CAI) nënkupton kodin unik të identifikimit të caktuar për çdo të Drejtë të Transmetimit Fizik nga Mjeti i Ankandit gjatë Ankandit “Shadow” . Kodi i identifikimit përdoret edhe kur përdorimi i të Drejtës Fizike të Transmetimit u propozohet Operatorëve të Sistemit të Transmetimit;

Limiti i Kredisë nënkupton shumën e kolateraleve që mund të përdoren për të mbuluar çdo paraqitje të Ofertës në Ankandet e mëvonshme dhe nuk përdoret për detyrimet e papaguara;

E drejta Ditore e Transmetimit nënkupton, për qëllimet e këtyre Rregullave për Alokimin “Shadow” , një të Drejtë Fizike të Transmetimit të fituar në Ankand “Shadow”;

Bashkimi i tregut një ditë përpara (day-ahead) nënkupton procesin e ankandit ku porositi e mbledhura përpunohen dhe kapaciteti ndërzonal alokohet njëkohësisht për zona të ndryshme ofertimi në tregun një ditë përpara;

Kodi EIC nënkupton Skemën e Kodimit të Identifikimit të Energjisë ENTSO-E që identifikon palët në një tregti ndërkufitare;

Ankandi Rezervë nënkupton procesin me të cilin Platforma e Alokimit i atribuon kapacitetet një Pjesëmarrësi të Regjistruar në rast se është aktivizuar modaliteti rezervë;

Forca Madhore nënkupton çdo ngjarje ose situatë të paparashikueshme ose të pazakontë përtej kontrollit të arsyeshëm të një Pale dhe/ose Operatorëve përkatës të Sistemit të Transmetimit, dhe jo për shkak të fajit të Palës dhe/ose Operatorëve përkatës të Sistemit të Transmetimit, që nuk mund të shmanget ose tejkalohet me largpamësi dhe zell të arsyeshëm, që nuk mund të zgjidhen me masa të cilat nga pikëpamja teknike, financiare ose ekonomike janë në mënyrë të arsyeshme të mundshme për Palën dhe/ose Operatorët përkatës të Sistemit të Transmetimit, që ka ndodhur realisht dhe është objektivist e verifikueshme dhe që e bën të pamundur që Pala dhe/ose Operatorët përkatës të Sistemit të Transmetimit të përmbushin, përkohësisht ose përgjithmonë, detyrimet e veta;

Rregullat e Sistemit të Informacionit nënkuptojnë termat dhe kushtet për qasjen dhe përdorimin e Mjetit të Ankandit nga Pjesëmarrësit e Regjistruar siç janë publikuar në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;

Çmimi Margjinal nënkupton çmimin e përcaktuar në një Ankand të veçantë për t'u paguar nga të gjithë Pjesëmarrësit e Regjistruar për çdo MË dhe orë të së Drejtës Ditore të fituar të Transmetimit;

Autoritetet Rregullatore Kombëtare nënkupton autoritetet rregullatore të referuara në nenin 35(1) të Direktivës 2009/72/KE ose, siç mund të jetë, legjislacionin e ngjashëm kombëtar;

Nominimi nënkupton njoftimin e përdorimit të Kapacitetit Ndërzonal nga një mbajtës i të Drejtave Fizike të Transmetimit dhe, nga pala e tij, ose një palë e tretë e autorizuar, për Operatorin(operatorët) përkatës të Sistemit të Transmetimit;

Rregullat e Nominimit nënkuptojnë rregullat në lidhje me njoftimin e përdorimit të të Drejtave të Transmetimit tek Operatori(operatorët) përkatës i Sistemit të Transmetimit;

Marrëveshja për Pjesëmarrje nënkupton marrëveshjen, me anë të së cilës, Palët marrin përsipër të respektojnë termat dhe kushtet për alokimin e kapaciteteve siç përmbahen në këto Rregulla për Alokimin "Shadow" ;

Pala/Palët nënkupton Platformën e Alokimit dhe/ose një Pjesëmarrës të Regjistruar të referuar individualisht si Palë ose kolektivisht si Palët;

E Drejta e Transmetimit Fizik nënkupton një të drejtë që e autorizon mbajtësin e saj të transferojë fizikisht një vëllim të caktuar të energjisë elektrike në një periudhë të caktuar kohore ndërmjet dy Zonave të Ofertimit në një drejtim të caktuar;

Periudha e Produktit nënkupton kohën dhe datën në të cilën fillon e drejta për të përdorur të Drejtën Ditore të Transmetimit dhe kohën dhe datën në të cilën përfundon e drejta për të përdorur të Drejtën Ditore të Transmetimit;

Pjesëmarrës i Regjistruar nënkupton një pjesëmarrës tregu i cili ka lidhur një Marrëveshje Pjesëmarrjeje me Platformën e Alokimit;

Dokumenti i të Drejtave nënkupton një dokument që përmban informacionin e sasisë maksimale të të Drejtave të Transmetimit Fizik (të identifikuar nga CAI) që mund të nominohet nga një pjesëmarrës tregu për kufirin e zonës së ofertimit në ditë në orë dhe për drejtim, duke marrë parasysh vëllimin e të Drejtave Ditore të Transmetimit të fituara fillimisht dhe çdo reduktim të mundshëm që ka ndodhur para lëshimit të Dokumentit të të Drejtave;

Rregullat për Alokimin "Shadow" nënkuptojnë rregullat për procedurën rezervë për alokimin e Kapacitetit Ndërzonal në kornizën kohore të tregut një ditë para, të aplikuara nga Platforma e Alokimit;

Ankandi "Shadow" nënkupton ankandi i qartë i drejtuar nga Platforma(t) e Alokimit me anë të të cilit Kapaciteti ditor ndërzonal ofrohet si procedurë rezervë për bashkimin e tregut një ditë përpara dhe u alokohet pjesëmarrësve të tregut që paraqesin oferta(t);

"Përdore ose Humbe" (UIOLI) nënkupton një aplikacion automatik me të cilin Kapaciteti ditor Ndërzonal i të Drejtave të panominuara të Transmetimit Fizik i kthehet në mënyrë të pakthyeshme OST(ve) përkatëse dhe ku mbajtësit e të Drejtave të Transmetimit që nuk nominojnë të përdorin të drejtat nuk kanë të drejtë të marrin një pagesë;

Ditë Pune nënkupton ditët kalendarike nga e hëna në të premte, me përjashtim të festave publike siç specifikohet në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;

Orari i Punës nënkupton orët e përcaktuara në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes.

3. Në këto Rregulla për Alokimin "Shadow" , përveç nëse konteksti kërkon ndryshe:
- (a) çdo referencë për fjalën kufi të Zonës së Ofertimit mund të mbulojë të gjithë ndërlidhësit kolektivisht ose vetëm një ose një nëngrup të ndërlidhësve në këtë kufi të Zonës së Ofertimit, siç specifikohet në Shtojcën 1 të këtyre Rregullave për Alokimin "Shadow" ;
 - (b) njëjësi tregon shumësin dhe anasjelltas;
 - (c) referencat për një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë e tjera;
 - (d) tabela e përmbajtjes, titujt dhe shembujt janë futur vetëm për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e Rregullave për Alokimin "Shadow" ;
 - (e) shprehja "duke përfshirë" dhe variacionet e saj duhet të interpretohen pa kufizim;
 - (f) çdo referencë ndaj legjislacionit, rregulloreve, direktivës, urdhrit, instrumentit, kodit ose ndonjë akti tjetër do të përfshijë çdo modifikim, zgjerim ose rimatim të tyre kur ishin në fuqi;
 - (g) çdo referen*cë për një marrëveshje ose dokument tjetër, ose ndonjë akt ose instrument tjetër duhet të interpretohet si referencë ndaj asaj marrëveshjeje tjetër, ose dokumenti, akti ose instrumenti tjetër të ndryshuar, variuar, plotësuar, zëvendësuar ose rinovuar herë pas here;
 - (h) referenca për kohën është referencë për kohën CET/CEST, përveç nëse specifikohet ndryshe; dhe
 - (i) kur Platformës së Alokimit i kërkohet të publikojë ndonjë informacion sipas këtyre Rregullave për Alokimin "Shadow" , ajo do ta bëjë këtë duke i vënë informacionin ose të dhënat e disponueshme në faqen e saj të internetit dhe/ose nëpërmjet Mjetit të Ankandit.

Neni 3

Platforma e Alokimit

1. Platforma e Alokimit do të ndërmarrë funksionet e alokimit në përputhje me këto Rregulla për Alokimin "Shadow" , legjislacionin e zbatueshëm të Bashkimit Evropian ose aktet ligjore në fuqi të Komunitetit të Energjisë dhe/ose legjislacionin kombëtar të zbatueshëm

të një ose më shumë vendeve kufitare të Zonës së Ofertimit.

2. Platforma e Alokimit do të zhvillojë Ankandin "Shadow" si për mosdisponueshmërinë e paparashikuar ashtu edhe për atë të parashikuar të bashkimit të tregut një ditë para në kufijtë përkatës të Zonës së Ofertimit. Ajo do të kryejë procesin e regjistrimit, do të trajtojë menaxhimin e nevojshëm të rrezikut financiar, do të përgatisë dhe kryejë Alokimet "Shadow", do të sigurojë të gjithë informatat e nevojshme për Pjesëmarrësit e Regjistruar dhe OST-të dhe do të mbledhë pagesat dhe/ose të paguajë sipas këtyre Rregullave për Alokimin "Shadow".
3. Për hir të qartësisë, Platforma e Alokimit hyn në një marrëdhënie kontraktuale me Pjesëmarrësit e Regjistruar. Emërimi i një Platforme të re Alokimi nuk do të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga Rregullat për Alokimin "Shadow".
4. Për qëllime të këtyre Rregullave për Alokimin "Shadow", Platforma e Alokimit do të jetë pala që nënshkruan Marrëveshjen e Pjesëmarrjes me Pjesëmarrësin e Regjistruar.
5. Për qëllime të Marrëveshjes së Pjesëmarrjes me Pjesëmarrësin e Regjistruar, Platforma e Alokimit do të publikojë një version të konsoliduar të këtyre Rregullave për Alokimin "Shadow" pasi ato të hyjnë në fuqi në përputhje me regjimet rregullatore kombëtare të zbatueshme. Në rast të një konflikti midis versionit të konsoliduar nga Platforma e Alokimit dhe Rregullave për Alokimin "Shadow" siç ka hyrë në fuqi në përputhje me regjimet rregullatore kombëtare të zbatueshme, kjo e fundit do të mbizotërojë.

Neni 4

Data e hyrjes në fuqi dhe aplikimi

1. Këto Rregulla për Alokimin "Shadow" do të hyjnë në fuqi në përputhje me regjimin rregullator kombëtar në fuqi dhe në datën e shpallur nga Platforma e Alokimit.
2. Këto Rregulla për Alokimin "Shadow" i nënshtrohen legjislacionit që mbizotëron në kohën kur ato hyjnë në fuqi. Nëse ka ndonjë ndryshim në legjislacion ose ndonjë veprim nga autoritetet kompetente në nivel kombëtar ose të Bashkimit Evropian që ka një efekt në këto Rregulla për Alokimin "Shadow", atëherë, pavarësisht nga çdo dispozitë tjetër e këtyre Rregullave për Alokimin "Shadow", këto të fundit do të ndryshohen në përputhje me rrethanat dhe sipas nenit 52.
3. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet Rregullave për Alokimin "Shadow" dhe Rregullave të Nominimit, për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e ankandëve "Shadow" në përputhje me Rregullat për Alokimin "Shadow", këto të fundit do të mbizotërojnë.
4. Aktivitetet e Platformës së Alokimit mbulojnë juridiksionet ku operojnë OST-të nga Bashkimi Evropian, OST-të nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe nga një ose më shumë vende të tjera. Referencat për (a) OST ose Operatorin e Sistemit të Transmetimit përfshijnë si rrjedhim referenca për OST-të e BE-së, operatorët e sistemit të transmetimit nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe operatorët e sistemit të transmetimit nga çdo vend tjetër për të cilin shërbimet ofrohen nga Platforma e Alokimit, dhe (b) NRA ose Autoriteti Rregullator Kombëtar përfshin referenca ndaj NRA-ve të Bashkimit Evropian, ose NRA-ve nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ose rregullatorëve të vendeve të tjera që kanë juridiksion mbi OST-në përkatëse ose Platformën e Alokimit.

KAPITULLI 2

Kërkesat dhe procesi për pjesëmarrje në Ankandet “Shadow” (Hije)

Neni 5

Dispozita e përgjithshme

1. Pjesëmarrësit e tregut mund të fitojnë një të Drejtë Transmetimi në kornizën e tregut një ditë para nëpërmjet Ankandeve “Shadow” vetëm nëse këto të fundit nisen nga një procedurë rezervë.
2. Pjesëmarrja në Ankandet “Shadow” kërkon që pjesëmarrësi i tregut:
 - (a) të lidhë një Marrëveshje Pjesëmarrjeje të vlefshme dhe efektive në përputhje me nenet 6 deri në 13; dhe
 - (b) të ketë qasje në Mjetin e Ankandit në përputhje me nenin 14.
3. Pjesëmarrja në Ankandet “Shadow” kërkon që pjesëmarrësit e tregut, përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin e mëparshëm, të plotësojnë edhe kushtet e mëposhtme:
 - (a) të jenë në përputhje me kërkesat për sigurimin e kolateraleve siç specifikohet në KAPITULLIN 3; dhe
 - (b) të kenë pranuar kushtet financiare shtesë kur nevojiten në përputhje me nenin 15.
4. Në çdo rast, pjesëmarrësit e tregut duhet t'i përmbushin detyrimet e përcaktuara në Kapitujt përkatës të këtyre Rregullave për Alokimin “Shadow” .

Neni 6

Lidhja e Marrëveshjes për Pjesëmarrje

1. Të paktën nëntë (9) ditë të punës para pjesëmarrjes së parë në një Ankand “Shadow” , çdo pjesëmarrës i tregut mund të aplikojë për të qenë palë në një Marrëveshje për Pjesëmarrje duke paraqitur, në Platformën e Alokimit, dy (2) kopje të nënshkruara të Marrëveshjes për Pjesëmarrje, në rast të nënshkrimeve të dhëna me dorë siç publikohen në faqen e internetit të Platformës së Alokimit, së bashku me të gjitha informatat dhe dokumentet e plotësuara siç duhet që kërkohen nga nenet 7 deri në 14. Marrëveshja për Pjesëmarrje do të nënshkruhet në mënyrë alternative me nënshkrim(e) të dhëna me dorë ose nënshkrime të kualifikuara elektronike (QES). Platforma e Alokimit do të vlerësojë plotësinë e informatave të dorëzuara në përputhje me nenet 8 dhe 11 brenda shtatë (7) Ditëve të Punës nga marrja e Marrëveshjes së përfunduar dhe të nënshkruar për Pjesëmarrje.
2. Platforma e Alokimit, para skadimit të afatit prej shtatë (7) Ditësh Pune, do t'u kërkojë pjesëmarrësve të tregut të sigurojnë çdo informacion të mbetur që pjesëmarrësit e tregut nuk e dorëzojnë me Marrëveshjen për Pjesëmarrje. Pas marrjes së informacionit të mbetur, Platforma e Alokimit do ta shqyrtojë informacionin brenda shtatë (7) Ditëve shtesë të Punës dhe do ta informojë pjesëmarrësin e tregut nëse kërkohet ndonjë informacion i mëtejshëm.

3. Pasi Platforma e Alokimit të ketë marrë të gjitha informatat e nevojshme, ajo do t'ia kthejë një kopje të Marrëveshjes për Pjesëmarrje, të nënshkruar prej saj, pjesëmarrësit të tregut pa vonesa të panevojshme. Nënshkrimi i Marrëveshjes për Pjesëmarrje nga Platforma e Alokimit nuk do të tregojë në vetvete pajtueshmërinë me ndonjë kusht tjetër të vendosur në këto Rregulla për Alokimin "Shadow" për pjesëmarrjen në Ankandet "Shadow". Marrëveshja për Pjesëmarrje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Platforma e Alokimit.
4. Është përgjegjësi e çdo pjesëmarrësi të tregut të sigurojë që ai është në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe, sipas rastit, legjislacionin e Bashkimit Evropian ose aktet ligjore të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë kërkesat e çdo autoriteti kompetent përkatës, dhe se ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme në lidhje me pjesëmarrjen e tij në Ankandet "Shadow".
5. Në rast se pjesëmarrësi i tregut është tashmë një Pjesëmarrës i Regjistruar në Platformën e Alokimit, ai duhet vetëm t'i plotësojë kërkesat që mungojnë/shtesë të përshkruara në këto Rregulla për Alokimin "Shadow", duke respektuar specifikat e paragrafit të mëparshëm të këtij neni.

Neni 7

Formulari dhe përmbajtja e Marrëveshjes për Pjesëmarrje

1. Formulari i Marrëveshjes për Pjesëmarrje dhe kërkesat për plotësimin e saj do të publikohen nga Platforma e Alokimit dhe mund të ndryshohen herë pas here nga Platforma e Alokimit, pa ndryshuar asnjë term dhe kusht të specifikuar në këto Rregulla për Alokimin "Shadow", përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këto të fundit.
2. Si minimum, Marrëveshja për Pjesëmarrje do të kërkojë nga pjesëmarrësit e tregut të:
 - (a) sigurojnë të gjitha informatat e nevojshme, në përputhje me nenin 8 dhe nenin 11; dhe
 - (b) pranojnë detyrimet dhe të pajtohen me këto Rregulla për Alokimin "Shadow".
3. Asgjë që përmendet në këto Rregulla për Alokimin "Shadow" nuk do të pengojë Platformën e Alokimit dhe Pjesëmarrësin e Regjistruar që të bien dakord për rregulla shtesë në Marrëveshjen për Pjesëmarrje, jashtë fushëveprimit të këtyre Rregullave për Alokimin "Shadow".
4. Në rast të vështirësisë në interpretim, kontradikta ose paqartësie ndërmjet këtyre Rregullave për Alokimin "Shadow" dhe Marrëveshjes për Pjesëmarrje, teksti i Rregullave për Alokimin "Shadow" do të mbizotërojë.

Neni 8

Dorëzimi i informatave

1. Pjesëmarrësi i tregut duhet t'i dorëzojë informatat e mëposhtme me Marrëveshjen e tij për Pjesëmarrje të plotësuar dhe të nënshkruar:
 - (a) emrin dhe adresën e regjistruar të pjesëmarrësit të tregut, duke përfshirë e-mailin e përgjithshëm dhe numrin e telefonit të pjesëmarrësit të tregut, për njoftimet në përputhje me nenin 58.
 - (b) nëse pjesëmarrësi i tregut është person juridik, një ekstrakt të regjistrimit të pjesëmarrësit

të tregut në regjistrin komercial të autoritetit kompetent;

- (c) detajet e kontaktit dhe emrat e personave të autorizuar për ta përfaqësuar pjesëmarrësin e tregut dhe funksionin e tyre;
 - (d) numrin e regjistrimit të TVSH-së së BE-së ose informata të ngjashme për identifikim tatimor ku TVSH-ja e BE-së nuk zbatohet;
 - (e) taksat dhe tarifat që duhet të merren parasysh për faturat dhe llogaritjet e kolateralit;
 - (f) Kodin e Identifikimit të Energjisë (EIC);
 - (g) informatat e llogarisë bankare për pagesën ndaj aplikantit, që do të përdoren nga Platforma e Alokimit për qëllimet e nenit 49 paragrafi 7;
 - (h) personin e kontaktit financiar për kolateralet, çështjet e faturimit dhe pagesave, dhe detajet e kontaktit të tyre (e-mail dhe numrin e telefonit) për njoftimet kur kërkohet në këto Rregulla për Alokimin "Shadow" , në përputhje me nenin 58;
 - (i) personin e kontaktit komercial dhe detajet e tij të kontaktit (e-mail dhe numrin e telefonit) për njoftimet kur kërkohet në këto Rregulla për Alokimin "Shadow" , në përputhje me nenin 58;
 - (j) personin e kontaktit operacional dhe detajet e kontaktit të tij (e-mail dhe numrin e telefonit) për njoftimet kur kërkohet në këto Rregulla për Alokimin "Shadow" , në përputhje me nenin 58; dhe
 - (k) Kodin e Regjistrimit të ACER (Kodi ACER) të caktuar nga Agjencia Evropiane për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) gjatë procesit të regjistrimit të pjesëmarrësve të tregut me NRA-në, për pjesëmarrje në alokim në kufijtë e Zonës së Ofertimit të listuar në Shtojcën 2.
2. Një Pjesëmarrës i Regjistruar do të sigurohet që të gjitha të dhënat dhe informatat e tjera që i ofron Platformës së Alokimit, në përputhje me këto Rregulla për Alokimin "Shadow" (duke përfshirë informatat në Marrëveshjen e tij për Pjesëmarrje), janë dhe mbeten të sakta dhe të plota në të gjitha aspektet materiale, dhe duhet ta njoftojë menjëherë Platformën e Alokimit për çdo ndryshim.
 3. Një Pjesëmarrës i Regjistruar do e njoftojë Platformën e Alokimit nëse ka ndonjë ndryshim në informatat e dorëzuara në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, të paktën nëntë (9) Ditë Pune para se ndryshimi të hyjë në fuqi dhe, kur kjo nuk është e mundur, pa vonesë pasi Pjesëmarrësi i Regjistruar njoftohet për ndryshimin.
 4. Platforma e Alokimit do të konfirmojë regjistrimin e ndryshimit ose do t'i dërgojë një shënim refuzimi të regjistrimit të ndryshimit Pjesëmarrësit të Regjistruar, më së voni shtatë (7) Ditë Pune pas marrjes së njoftimit përkatës të ndryshimit. Shënimi i konfirmimit ose refuzimit do të dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike, siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Nëse Platforma e Alokimit refuzon ta regjistrojë ndryshimin, arsyeja do të jepet në shënimin e refuzimit.
 5. Ndryshimi bëhet i vlefshëm në ditën e dorëzimit të konfirmimit tek Pjesëmarrësi i Regjistruar.
 6. Nëse kërkohen informata shtesë nga një Pjesëmarrës i Regjistruar, si pasojë e një ndryshimi në këto Rregulla për Alokimin "Shadow" , atëherë Pjesëmarrësi i Regjistruar do t'i dorëzojë

informatat shtesë në Platformën e Alokimit brenda dymbëdhjetë (12) Ditëve të Punës, pas kërkesës për një dorëzim të tillë nga Platforma e Alokimit.

Neni 9
Garancitë

1. Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Pjesëmarrje, pjesëmarrësi i tregut garanton që:
 - (a) nuk ka të nisur asnjë procedurë për të kërkuar një vendim insolvency ose falimentimi, ose ndonjë lehtësim tjetër sipas ndonjë ligji për falimentimin ose insolvencën ose ndonjë ligj tjetër të ngjashëm që prek të drejtat e kreditorëve;
 - (b) nuk ka të nisur asnjë procedurë insolvency, falimentimi ose procedura të tjera të ngjashme ligjore që prekin të drejtat e kreditorëve në lidhje me aplikantin;
 - (c) nuk ka të nisur asnjë procedurë shuarje ose likuidimi në lidhje me aplikantin; dhe
 - (d) nuk ka detyrime pagese të vonuara ndaj Platformës së Alokimit.

Neni 10
Llogaria e Dedikuar e Biznesit

Si pjesë e dorëzimit të informatave në përputhje me nenin 6 dhe nenin 8, një llogari e dedikuar biznesi vihet në dispozicion të pjesëmarrësit të tregut për qëllime të depozitimit të kolateraleve në para të gatshme dhe/ose për qëllime të kryerjes së pagesave në bazën e përshkruar në nenin 49.

Neni 11
Pranimi i Rregullave të Sistemit të Informacionit

Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Pjesëmarrje, pjesëmarrësi i tregut pranon Rregullat e aplikueshme të Sistemit të Informacionit, të ndryshuara herë pas here dhe të publikuara në faqen e internetit të Platformës së Alokimit.

Neni 12
Kostot që lidhen me Marrëveshjen për Pjesëmarrje

Të gjitha aplikimet për t'u bërë Pjesëmarrës i Regjistruar dhe çdo pjesëmarrje e mëvonshme në Ankandet "Shadow" do të bëhen me kostot, shpenzimet dhe marrjen e rrezikut nga vetë Pjesëmarrësit e Regjistruar. Platforma e Alokimit nuk do të jetë përgjegjëse ndaj asnjë personi për asnjë kosto, dëmtim ose shpenzim në lidhje me Pjesëmarrësin e Regjistruar që merr pjesë në Ankandet "Shadow", përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në mënyrë të qartë në këto Rregulla për Alokimin "Shadow".

Neni 13
Refuzimi i aplikacionit

Platforma e Alokimit mund të refuzojë të lidhë një Marrëveshje për Pjesëmarrje me një pjesëmarrës tregu në rrethanat e mëposhtme:

- (a) kur aplikanti nuk ka paraqitur një Marrëveshje për Pjesëmarrje të plotësuar dhe të nënshkruar siç duhet në përputhje me nenet 6, 7 dhe 8; ose

- (b) Platforma e Alokimit ka ndërprerë më parë një Marrëveshje për Pjesëmarrje me aplikantin si rezultat i një shkeljeje të Marrëveshjes për Pjesëmarrje nga ana e Pjesëmarrësit të Regjistruar, në përputhje me nenin 56 (3) dhe (4) dhe, përveç nëse rrethanat që çuan në ndërprerje kanë pushuar së ekzistuari ose Platforma e Alokimit është e sigurt në mënyrë të arsyeshme që shkelja nuk do të ndodhë më; ose
- (c) nëse hyrja në një Marrëveshje për Pjesëmarrje me aplikantin do të bënte që Platforma e Alokimit të shkelte ndonjë kusht të ndonjë kërkesë të detyrueshme ligjore ose rregullatore; ose
- (d) nëse ndonjë nga garancitë e Pjesëmarrësit të Regjistruar sipas nenit 9 rezulton të jetë e pavlefshme ose e rreme;
- (e) nëse aplikanti është nën sanksione ekonomike dhe tregtare të cilat mund të kenë ndikim domethënës në Platformën e Alokimit.

Neni 14

Qasja në Mjetin e Ankandit

1. Platforma e Alokimit do të japë qasje në Mjetin e Ankandit pa pagesë, nëse plotësohen kërkesat e mëposhtme:
 - (a) Pjesëmarrësi i Regjistruar ka nënshkruar dhe ka dorëzuar një formular të plotësuar të përfshirë në Rregullat e Sistemit të Informacionit që identifikon personin(personat) për të cilin do të krijohet llogaria(llogaritë) e përdoruesit në Mjetin e Ankandit; dhe
 - (b) Pjesëmarrësi i Regjistruar ka përmbushur kërkesat për vërtetimin e përcaktuar nga Rregullat e Sistemit të Informacionit të publikuara nga Platforma e Alokimit.
2. Platforma e Alokimit do ta konfirmojë krijimin e llogarisë së përdoruesit ose mund t'i dërgojë një shënim refuzimi Pjesëmarrësit të Regjistruar, më së voni pesë (5) Ditë Pune pas marrjes së formularit përkatës të nënshkruar dhe të plotësuar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar. Shënimi i konfirmimit ose refuzimit do të dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit.
3. Platforma e Alokimit do ta dërgojë notën (shënimin) e refuzimit të arsyetuar siç duhet nëse kërkesat e renditura në paragrafin 1 të këtij neni nuk plotësohen, dhe nuk do jepet qasja në Mjetin e Ankandit.

Neni 15

Dakordimi për kushtet financiare shtesë

Platforma e Alokimit mund të zhvillojë dhe publikojë kushte standarde financiare shtesë për t'u pranuar nga Pjesëmarrësit e Regjistruar. Këto kushte financiare shtesë mund të përfshijnë dispozita për të mundësuar kolaterale të përbashkëta për procese të tjera të organizuara nga Platforma e Alokimit në përputhje me Marrëveshjen për Pjesëmarrje, për sa kohë që këto kushte financiare shtesë përputhen me këto Rregulla për Alokimin "Shadow" .

Neni 16

Kërkesat rregullatore dhe ligjore

Është përgjegjësi e çdo pjesëmarrësi të tregut të sigurojë që ai është në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe, kur është e zbatueshme, legjislacionin e Bashkimit Evropian ose aktet ligjore të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë kërkesat e çdo autoriteti kompetent përkatës, dhe se ka marrë

të gjitha autorizimet e nevojshme në lidhje me pjesëmarrjen e tij në Ankandet "Shadow" ose në përdorimin e të Drejtave Ditore të Transmetimit.

KAPITULLI 3

Kolateralet

Neni 17

Dispozitat e përgjithshme

1. Pjesëmarrësit e Regjistruar do të ofrojnë kolaterale për t'i siguruar pagesat për Platformën e Alokimit që rezultojnë nga Ankandet "Shadow" të Drejtave Ditore të Transmetimit dhe, kur është e aplikueshme, pagesat e tjera të mundshme që duhet të kryhen sipas kushteve financiare shtesë në përputhje me nenin 15.
2. Vetëm format e mëposhtme të kolateralit do të pranohen:
 - (a) një Garanci Bankare;
 - (b) një depozitë në para të gatshme në një Llogari të dedikuar Biznesi.
3. Kolateralet mund të sigurohen në një nga format e përmendura në pikën 2 të këtij neni ose një kombinim i këtyre formave, me kusht që Platforma e Alokimit të ketë të drejtën përfituese të kolateralit të plotë.
4. Limiti i kredisë duhet të jetë gjithmonë më i madh ose i barabartë me zero.
5. Kolateralet do të jepen në Euro (€).

Neni 18

Forma e depozitës në para të gatshme

Për kolateralet që jepen në formën e një depozite në para të gatshme në një Llogari të dedikuar Biznesi, kushtet e mëposhtme do të zbatohen:

- (a) paratë do të depozitohen në një Llogari të dedikuar Biznesi në një institucion financiar të zgjedhur nga Platforma e Alokimit;
- (b) Llogaria e dedikuar e Biznesit do të hapet dhe përdoret sipas kushteve financiare shtesë në përputhje me nenin 15;
- (c) deri në tërheqjen siç lejohet nga dispozitat e mëposhtme të nenit 24, depozitimi i parave të gatshme në Llogarinë e dedikuar të Biznesit i takon Pjesëmarrësit të Regjistruar, nëse nuk përcaktohet ndryshe në kushtet financiare shtesë në përputhje me nenin 15;
- (d) tërheqjet nga Llogaria e dedikuar e Biznesit në përputhje me nenin 22 dhe nenin 24 mund të bëhen vetëm me udhëzimin e Platformës së Alokimit;
- (e) Llogaria e dedikuar e Biznesit mund të përdoret edhe për shlyerje, siç parashikohet në nenin 49; dhe
- (f) interesi mbi shumën e depozituar në Llogarinë e dedikuar të Biznesit do të rritet për përfitimin e Pjesëmarrësit të Regjistruar, pas zbritjes së taksave dhe tarifave bankare, nëse ka.

Formulari i Garancise Bankare

1. Kolateralet që jepen në formën e një garancie bankare duhet të jenë në përputhje me specifikimet e mëposhtme:
 - (a) Garancia Bankare do të jepet në formë të shabllonit që është i disponueshëm në faqen e internetit të Platformës së Alokimit dhe i përditësuar herë pas here ose në një formë që ndjek në thelb shabllonin;
 - (b) Garancia Bankare do të shkruhet në gjuhën angleze;
 - (c) Garancia Bankare mbulon të gjitha ankandet e organizuara nga Platforma e Alokimit sipas kushteve financiare shtesë në përputhje me nenin 15;
 - (d) Garancia Bankare do të lejojë tërheqje të pjesshme dhe të shumëfishta nga platforma e alokimit, deri në shumën maksimale të garantuar;
 - (e) Garancia Bankare do të sigurojë pagesën pas kërkesës së parë të Platformës së Alokimit. Ajo do të parasheh më tej që nëse Platforma e Alokimit kërkon Garancinë Bankare, banka do të paguajë automatikisht pa asnjë kusht tjetër përveç marrjes së një kërkesë të dërguar nga SËIFT nëpërmjet bankës ndërmjetëse që konfirmon se nënshkrimet në kërkesë janë në përputhje me ekzemplarën e mbajtur nga banka.
 - (f) Garancia bankare është e parevokueshme, e pakushtëzuar dhe e patransferueshme;
 - (g) Garancia Bankare mund të përfshijë një alternativë nënshkrimi(nënshkrimeve) me dorë ose nënshkrim (nënshkrimeve) elektronike të kualifikuara (NQE) nga banka emetuese. Në rast se Garancia Bankare nënshkruhet me nënshkrim(e) elektronik të kualifikuar (NQE), të gjitha ndryshimet e mëposhtme do të nënshkruhen me një nënshkrim(ë) elektronik të kualifikuar (NQE);
 - (h) banka që lëshon Garancinë Bankare do të themelohet në mënyrë të përhershme, duke përfshirë një degë në një shtet anëtar të BE-së, Zonën Ekonomike Evropiane, Palën Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, vendin vëzhgues të Komunitetit të Energjisë, ose në Zvicër dhe do të jetë e pranueshme për bankën e biznesit të Platformës së Alokimit;
 - (i) banka që lëshon garancinë bankare ose grupi financiar të cilit i përket do të ketë një vlerësim afatgjatë të kredisë jo më pak se BBB- nga "Standard and Poor's Corporation BBB- "nga Fitch ose "Baa3" nga Moody's Investors Service Inc. Nëse banka emetuese ose grupi financiar, të cilit i përket banka emetuese, nuk ka më vlerësimin e kërkuar të kredisë afatgjatë, pjesëmarrësi i regjistruar duhet t'i paraqesë Platformës së Alokimit brenda pesë (5) ditëve të punës një garanci bankare zëvendësuese nga një bankë që përmbush vlerësimin e kërkuar të kredisë afatgjatë ose zëvendësoni garancinë bankare me depozitë. Nëse ka ulje të klasifikimit të institucioneve financiare në mbarë industrinë, Platforma e Alokimit mund të hulumtoj se cilat janë standardet e reja dhe, sipas gjykimit të saj, nëse e sheh të nevojshme, të ulë vlerësimin e kërkuar për një periudhë të kufizuar kohore, duke informuar Operatorët e Sistemit të Transmetimit dhe duke kërkuar nga ata të informojnë Autoritetet Kombëtare Rregullative.
 - (j) banka që lëshon Garancinë Bankare nuk duhet të jetë Filial i Pjesëmarrësit të

Regjistruar për të cilin është lëshuar Garancia Bankare.

2. Garancia bankare duhet të përmbajë sa vijon:
 - (a) një shumë maksimale të garantuar;
 - (b) identifikimin e platformës së alokimit si përfitues, siç specifikohet në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;
 - (c) llogarinë bankare të Platformës së Alokimit, siç specifikohet në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;
 - (d) adresën e bankës së Platformës së Alokimit, siç specifikohet në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;
 - (e) identifikimin e plotë të pjesëmarrësit të regjistruar, duke përfshirë emrin, adresën, regjistrin tregtar/kompani;
 - (f) identifikimin e plotë të bankës siguroese; dhe
 - (g) koha e validitetit.
3. Pjesëmarrësi i regjistruar duhet të dorëzojë garancinë bankare të paktën katër (4) ditë pune para mbylljes së periudhës së ofertimit të ankandit “Shadow” për të cilin do të përdoret si kolateral ose përndryshe do të konsiderohet për ankandet e mëvonshme “Shadow”.
4. Platforma e Alokimit do të pranojë garancinë bankare të ofruar nga një pjesëmarrës i regjistruar nëse garancia bankare është dhënë në përputhje me specifikimet e përcaktuara në paragrafin 1 deri në 2 të këtij neni dhe nëse garancia bankare përfshin nënshkrim(et) me dorë, origjinali i Garancisë Bankare merret nga Platforma e alokimit.
5. Platforma e Alokimit do të konfirmojë pranimin e Garancisë Bankare ose do të dërgoj një notë refuzimi tek pjesëmarrësi i regjistruar, më së voni katër (4) ditë pune pas marrjes së origjinalit të Garancisë Bankare. Nota e konfirmimit ose refuzimit do të dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Nota e refuzimit duhet të përfshijë arsyetimin e refuzimit.

Neni 20

Vlefshmëria dhe rinovimi i Garancisë Bankare

1. Kolateralet në formë të Garancisë Bankare do të jenë të vlefshme për periudhën minimale deri në të paktën tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të muajit kalendarik të periudhës së produktit.
2. Gjatë kësaj periudhe, pjesëmarrësi i regjistruar do të mbajë në çdo kohë kolateralet në formë të një garancie bankare, e cila përfshin detyrimin e pjesëmarrësit të regjistruar që të zëvendësoj ose rinovoj ato sipas nevojës.

Neni 21

Limiti i kreditit

1. Platforma e Alokimit do të llogarisë dhe përditëson vazhdimisht Limitin e Kreditit të secilit pjesëmarrës të regjistruar në lidhje me çdo ankand të mëpasshëm. Limiti i kredisë do të jetë i barabartë me shumën e kolateraleve në vend minus çdo detyrim pagese të papaguar. Në rastin

e një garancie bankare, kjo garanci bankare do të merret parasysh vetëm nëse plotësohen kërkesat e nenit 20 në lidhje me validitetin e saj për ankandin përkatës “Shadow”. Platforma e Alokimit do ta bëjë këtë informacion të disponueshëm për secilin Pjesëmarrës të Regjistruar individualisht përmes Mjetit të Ankandit.

2. Detyrimet e papaguara llogariten sipas nenit 47 që i nënshtrohen rregullave shtesë në paragrafin 3 deri në 4 të këtij neni dhe në nenin 32.
3. Për qëllim të llogaritjes së limitit të kredisë, detyrimet e papaguara do të rriten për të përfshirë tatimet dhe taksat në fuqi, sipas nenit 48.
4. Detyrimet maksimale të pagesës për një pjesëmarrës të regjistruar që rezultojnë nga oferta(t) e tij e regjistruar në mbylljen e periudhës së ofertimit, e llogaritur sipas nenit 32, do të konsiderohet përkohësisht si detyrime të papaguara. Nga publikimi i rezultateve të ankandit “Shadow”, shumat e caktuar e njoftuar sipas nenit 34 paragrafi 3 (b) dhe (c) do të konsiderohet si detyrim i papaguar për llogaritjen e limitit të kredisë për çdo ankand të njëkohshëm dhe limiti i kredisë do të rishikohet bazuar në të drejtat ditore të transmetimit.

Neni 22

Modifikimet e kolateraleve

1. Një pjesëmarrës i regjistruar mund të kërkojë me shkrim rritjen e kolateraleve në formën e një garancie bankare, një ulje të kolateraleve në formën e garancisë bankare dhe/ose depozitim në para ose ndryshim të formës së kolateraleve në çdo kohë në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.
2. Ulja e kolateraleve të një pjesëmarrësi të regjistruar do të lejohet vetëm nëse Limiti i Kreditit pas aplikimit të uljes së kërkuar të kolateraleve do të ishte më i madh ose barabartë me zero.
3. Platforma e Alokimit do të pranojë modifikimi të kolateraleve nëse kërkesa për ndryshimin e kolateralit është në përputhje me kushtin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni në rast të uljes ose me kushtet e përcaktuara në nenet 19 dhe 20 në rast të rritjes së kolateralit në formë të një garancie bankare dhe në rast të ndryshimit të formës së kolateraleve nga para në depozitë në garanci bankare.
4. Modifikimi i kolateraleve do të bëhet valid dhe efektiv vetëm kur Platforma e Alokimit ka bërë modifikimin e kërkuar të kolateraleve të pjesëmarrësit të regjistruar brenda mjetit të ankandit.
5. Platforma e Alokimit do të vlerësojë kërkesën për modifikim të kolateraleve dhe të konfirmojë pranimin ose t'i dërgojë një notë refuzimi pjesëmarrësit të regjistruar, më së voni dy (2) ditë pune pas marrjes së kërkesës. Nota e konfirmimit ose refuzimit do të dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Nota refuzuese duhet të përfshijë arsyetimin për refuzimin.

Neni 23

Incident i kolateralit

1. Një incident i kolateralit ndodh në rastet e mëposhtme:
 - (a) kolaterale janë të pamjaftueshme për të siguruar shumën e detyrimit për të drejtat ditore të transmetimit të mbajtura nga një pjesëmarrës i regjistruar në datën e pagesës së radhës siç përcaktohet në nenin 49, duke marrë parasysh shumën dhe vlefshmërinë e kolateraleve; ose

- (b) kolaterale nuk mbahen në përputhje me nenin 20 paragrafi 2; ose
 - (c) kolaterale nuk rikthehen pas një incidenti të pagesës në përputhje me nenin 24 ose është dhënë kolateral i ri që nuk është në përputhje me kushtet e specifikuar në nenet 17(3), 18 dhe 19.
2. Platforma e Alokimit do të njoftojë incidentin e kolateraleve për pjesëmarrësin e regjistruar me mjete elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Pjesëmarrësi i regjistruar do të rrisë kolaterale të tij brenda dy (2) ditëve të punës nga dërgimi i njoftimit nëse kjo bëhet gjatë orarit të punës ose dy (2) ditëve të punës duke filluar nga dita e vijuese e punës, nëse dërgohet pas orarit të punës. Nëse kolaterale të dhëna nga pjesëmarrësi i regjistruar mbeten të pamjaftueshme pas kësaj periudhe, Platforma e Alokimit mund të pezullojë ose të ndërpres Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në përputhje me nenet 55 dhe 56.

Neni 24

Thirrjet në kolaterale

1. Platforma e Alokimit ka të drejtë të kërkojë kolaterale të një pjesëmarrësi të regjistruar në rast të një incidenti pagese të regjistruar në përputhje me nenin 51.
2. Pjesëmarrësi i regjistruar do të rikthejë kolaterale të tij pas një incidenti pagese ose incidenti kolateralesh duke ndjekur kushtet e përcaktuara në nenet 17(3), 18 dhe 19, përveç rastit kur Marrëveshja e Pjesëmarrjes pezullohet ose ndërpritet në përputhje me nenet 55 dhe 56.

KAPITULLI 4

Ankandet “Shadow” (Hije)

Neni 25

Dispozitat e përgjithshme për ankandet në hije

1. Ankandet “Shadow” mund të aktivizohen gjatë sesionit të bashkimit të tregut një ditë para (day-ahead) kur ndodh një incident i paparashikueshëm ose mund të aktivizohen paraprakisht nëse dihet se bashkimi i tregut një ditë para nuk do të jetë i disponueshëm për sesionet e ardhshme. Në secilin rast, Platforma e Alokimit do të njoftojë sa më shpejt që të jetë e mundur pjesëmarrësit e regjistruar të interesuar se ankandet “Shadow” mund të fillojnë.
2. Platforma e Alokimit do të ndajë të Drejtat e Transmetimit për Pjesëmarrësit e Regjistruar përmes alokimit eksplisit. Ankandet “Shadow” (hije) do të organizohen nëpërmjet mjetit të ankandit. Secili pjesëmarrës i regjistruar që përmbush kërkesat për pjesëmarrje në ankand “Shadow” mund të bëjë ofertat për kufijtë e zonës së ofertimit për të cilin ata kanë të drejtë sipas neneve 28 dhe 30.
3. Pasi të ketë skaduar afati përkatës për vendosjen e ofertave në ankand të veçantë “Shadow”, Platforma e Alokimit do të vlerësojë ofertat duke përfshirë edhe kundrejt limiteve përkatëse kreditore së pjesëmarrësve të regjistruar. Rezultatet e ankandit “Shadow” do t'u njoftohen pjesëmarrësve të regjistruar nëpërmjet mjetit të ankandit.

Neni 26

Procesi i ankandit “Shadow” (në hije)

1. Nëse ankandet “Shadow” aktivizohen gjatë një sesioni të bashkimit të tregut një ditës para (day-ahead), ankandet “Shadow” mund të hapen paralelisht me zgjidhjen e problemit të bashkimit të tregut një ditë para, por rezultatet e ankandit “Shadow” do të merren parasysh vetëm nëse deklarohet ndarja (ang. Decoupling). Platforma e alokimit do të informojë pjesëmarrësit e regjistruar të interesuar se ankandet “Shadow” mund të fillojnë. Pjesëmarrësit e regjistruar kanë mundësinë të futin ose modifikojnë ofertat e dorëzuara deri në mbyllje - afatin e fundit për vendosjen e ofertave në ankandet ditore “Shadow”. Platforma e Alokimit importon ofertat e paracaktuara të paraqitura për ankandet “Shadow” sipas nenit 30 dhe informon pjesëmarrësit e regjistruar për afatin e fundit për përditësimin e ofertave të tyre. Rezultatet e ankandëve “Shadow” nuk publikohen në këtë kohë. Nëse përfundimisht deklarohet ndarja, pjesëmarrësit e regjistruar njoftohen për rezultatet e ofertave sipas nenit 34.

Nëse aktivizimi i ankandëve “Shadow” dihet paraprakisht për një ose disa sesione ditore të bashkimit të tregut një ditë para, Platforma e Alokimit informon sa më shpejt të jetë e mundur individualisht, me një email, pjesëmarrësit e regjistruar se ankandet “Shadow” do të mbahen sipas orarit të ri përkatës. Kapaciteti i ofruar për ankandet “Shadow” dhe informacioni në lidhje me orarin do të publikohen në Specifikimin e Ankandit në faqen e internetit të platformës së alokimit siç specifikohet në nenin 27 në mënyrë që t'u jepet mundësia pjesëmarrësve të përditësojnë ofertat e tyre sipas neneve 28, 29. dhe 30.

2. Platforma e Alokimit në asnjë rrethanë nuk mund të mbahet përgjegjëse nëse nuk është në gjendje të kontaktojë pjesëmarrësit e regjistruar ose nëse nuk është në gjendje të publikojë njoftimin në faqen e saj të internetit.

Neni 27

Specifikimi i ankandit

1. Nëse ankandet “Shadow” aktivizohen gjatë sesioni ditor të bashkimit të tregut një ditë para (day-ahead), specifikimi i ankandit publikohet 15 minuta para hapjes së periudhës së ofertimit. Nëse aktivizimi i ankandeve “Shadow” dihet paraprakisht, Platforma e Alokimit do të publikojë Specifikimin e Ankandit siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni jo më vonë se **09:00 para ditës** që vijon nga dita e dorëzimit.
2. Specifikimi i ankandit në veçanti përcakton:
 - (a) kodin që identifikon ankandin “Shadow” në mjetin e ankandit;
 - (b) identifikimin e kufirit(ve) të zonës së ofertimit ose një nëngrupi të ndërlidhësve në kufirin e zonës së ofertimit dhe drejtimin e mbuluar;
 - (c) Periudha e produktit;
 - (d) Periudha e Ofertimit që zgjat për **15 minuta**, nëse Ankandet “Shadow” aktivizohen gjatë një sesioni ditor të bashkimit të tregut një ditë para. Nëse aktivizimi i ankandeve “Shadow” dihet paraprakisht, periudha e ofertimit fillon në orën 09:00 dhe përfundon në orën 09:30 të ditës që i paraprin ditës së dorëzimit;
 - (e) afati i fundit për publikimin e rezultateve provizionale të ankandit “Shadow”;
 - (f) periudha e kontestimit në përputhje me nenin 34;
 - (g) afati i fundit për publikimin e rezultateve përfundimtare të ankandit “Shadow”;
 - (h) kapacitetin e ofruar; dhe
 - (i) çdo informacion tjetër përkatës ose kushtet e zbatueshme për produktin ose Ankand “Shadow”.

Neni 28

Dorëzimi i ofertave

1. Pjesëmarrësi i regjistruar duhet të dorëzojë një ofertë ose grup ofertash për platformën e alokimit në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
 - (a) të dorëzohen në mënyrë elektronike duke përdorur mjetin e ankandit dhe gjatë periudhës së ofertimit siç specifikohet në Specifikimin e ankandit;
 - (b) të identifikohet ankandi “Shadow” nëpërmjet një kodi identifikues siç specifikohet në nenin 27 paragrafi 2 (a);
 - (c) të identifikojë pjesëmarrësin e regjistruar që dorëzon ofertën përmes kodit të tij EIC;
 - (d) të identifikojë kufirin e zonave të ofertimit dhe drejtimin për të cilin është dorëzuar oferta;
 - (e) të deklaroj çmimin e ofertës, i cili do të jetë i ndryshëm për secilën ofertë të të njëjtit

pjesëmarrës të regjistruar, pa përfshirë tatimet dhe taksa, në euro për MË për një orë të Periudhës së Produktit, dmth Euro/MË dhe orë, e shprehur në maksimum dy (2) shifra dhjetore dhe të barabarta ose më të mëdha se zero;

- (f) të deklaroj sasinë e ofertës në MË të plotë e cila duhet të shprehet pa vlera decimale, dhe shuma minimale e një oferte të vetme është një (1) MË.
2. Pjesëmarrësi i regjistruar mund të modifikojë ofertën e tij të regjistruar më parë ose grupin e ofertave në çdo kohë gjatë periudhës së ofertimit duke përfshirë anulimin e saj. Në rast se oferta është modifikuar, vetëm modifikimi i fundit i vlefshëm i ofertës ose grupit të ofertave do të merret parasysh për përcaktimin e rezultateve të ankandit "Shadow".
 3. Nëse një sasi e ofertës, ose një sasi e llogaritur si shuma e sasisë së ofertës për disa oferta të paraqitura për të njëjtin ankand "Shadow" gjatë periudhës së ofertimit, nga një pjesëmarrës i regjistruar tejkalon kapacitetin e ofruar të shpallur në Specifikimin e ankandit, kjo ofertë ose këto oferta do të refuzohen plotësisht. Kur modifikim i ofertave të paraqitura më parë rezulton në tejkalimin e kapacitetit të ofruar, modifikimi do të refuzohet dhe ofertat e regjistruara më parë do të qëndrojnë në fuqi.

Neni 29 **Regjistrimi i ofertës**

1. Platforma e Alokimit nuk do të regjistroj ofertën që:
 - (a) nuk përputhet me kërkesat e nenit 28; ose
 - (b) është dorëzuar nga një pjesëmarrës i regjistruar i cili është pezulluar në përputhje me nenin 55.
2. Me kusht që një ofertë ose grup ofertash përmbush kërkesat e përcaktuara në nenet 28, Platforma e Alokimit do t'i konfirmojë pjesëmarrësit të regjistruar që oferta(a) është regjistruar saktë me një konfirmim të pranimit nëpërmjet mjetit të ankandit. Nëse Platforma e Alokimit nuk lëshon konfirmimin për marrjen e një oferte, kjo ofertë do të konsiderohet se nuk është regjistruar.
3. Platforma e Alokimit do të njoftojë pjesëmarrësin e regjistruar, oferta e të cilit është refuzuar si e pavlefshme, së bashku me arsyen e këtij refuzimi, pa vonesa të panevojshme pasi oferta të jetë refuzuar.
4. Platforma e Alokimit do të mbajë një regjistër të të gjitha ofertave të vlefshme të pranuar.
5. Secila ofertë valide e regjistruar në mbyllje të periudhës së ofertimit do të përbëjë një ofertë të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme nga Pjesëmarrësi i Regjistruar për të blerë të Drejtat Ditore të Transmetimit deri në Sasinë e Ofertës dhe me çmime deri në Çmimin e Ofertës dhe sipas termave dhe kushteve të këtyre Rregullave të Alokimit "Shadow" dhe specifikimi përkatës i ankandit.

Neni 30 **Oferta e paracaktuar**

1. Pjesëmarrësi i regjistruar që dëshiron të marrë pjesë në ankandet "Shadow" ka mundësinë të vendosë oferta të paracaktuara për ankandet "Shadow".
2. Një ofertë e paracaktuar, pasi të identifikohet si e tillë nga Pjesëmarrësi i Regjistruar, do të

zbatohet automatikisht për çdo ankand të mëpasshëm, siç përcaktohet nga pjesëmarrësi i regjistruar kur vendos ofertën e paracaktuar. Në hapjen e periudhës përkatëse të ofertimit, oferta e regjistruar e paracaktuar do të konsiderohet si ofertë e dorëzuar nga pjesëmarrësi i regjistruar për ankandin përkatës "Shadow". Kjo ofertë do të konsiderohet e dorëzuar kur Platforma e Alokimit i dërgon konfirmimin e pranimit pjesëmarrësit të regjistruar.

3. Nëse një sasi e paracaktuar e ofertës ose një sasi e llogaritur si shumë e sasisë së ofertës për disa oferta të paracaktuara të paraqitura për të njëjtin ankand "Shadow" nga një pjesëmarrës i regjistruar tejkalon kapacitetin përfundimtar të ofruar, ofertat me çmimin më të ulët do të refuzohen një (1) nga një (1) derisa sasia totale e lejuar e ofertës të jetë më e ulët ose e barabartë me kapacitetin e ofruar.
4. Një pjesëmarrës i regjistruar i cili dëshiron të modifikojë ofertën e paracaktuar për një ankand "Shadow" të ardhshëm do të ndryshojë sasinë dhe çmimin e ofertave të tij të paracaktuara përpara hapjes së Periudhës së Ofertimit të Ankandit "Shadow".
5. Një pjesëmarrës i regjistruar që nuk dëshiron të paraqesë ofertën e paracaktuar në mjetin e ankandit për ankandet e ardhshme "Shadow", mund të anulojë ofertat e tij të paracaktuara përpara hapjes së periudhës pasuese të ofertimit të ankandit.

Neni 31

Oferta e paracaktuar për ankandin rezervë (fallback auction)

Nëse zhvillohet një ankand rezervë në përputhje me nenin 42, ofertat e paracaktuara të dorëzuara deri në orën 14:00 D-2 do të përdoren si oferta të paracaktuara për ankandin rezervë.

Neni 32

Verifikimi i limitit të kredisë

1. Me dorëzimin e një oferte ose grupi ofertash në mjetin e ankandit nga një pjesëmarrës i regjistruar, platforma e alokimit do të kontrollojë nëse detyrimet maksimale të pagesës (DMP) që lidhen me ofertën(at) e regjistruara të atij pjesëmarrësi të regjistruar të llogaritura sipas paragrafëve 4 dhe 5 të këtij neni në momentin e dorëzimit të ofertave tejkalojnë limitin e kredisë. Nëse detyrimi maksimal i pagesës në lidhje me ofertat e tilla të regjistruara tejkalon limitin e kreditit, Platforma e Alokimit nëpërmjet Instrumentit të Ankandit do të lëshojë automatikisht një paralajmërim për pjesëmarrësin e regjistruar që të modifikoj ofertat. Ofertat nuk do të refuzohen automatikisht nëse detyrimi maksimal i pagesës që i atribuohet ofertave të regjistruara tejkalon limitin e kredisë në dorëzimin e ofertës, por vetëm pas procesit të përshkruar në paragrafin 2 të këtij neni.
2. Në mbyllje të Periudhës së Ofertimit, Platforma e Alokimit do të kontrollojë sërish nëse detyrimet maksimale të pagesës lidhur me ofertat e regjistruara të llogaritura sipas paragrafit 5 të këtij neni e kalojnë limitin e kredisë. Nëse detyrimet maksimale të pagesës në lidhje me këto oferta tejkalojnë limitin e kredisë, këto oferta, duke filluar me ofertën me çmimin më të ulët të ofertës, do të përjashtohen një (1) nga një (1), derisa detyrimet maksimale të pagesës të jenë më të vogla ose të barabarta me limitin e kredisë.
3. Platforma e Alokimit do të tregojë kolaterale të pamjaftueshme si arsye e përjashtimit të ofertës në njoftimin e rezultateve të ankandit "Shadow" për pjesëmarrësin e regjistruar.

4. Platforma e Alokimit do të vlerësojë vazhdimisht të gjitha ofertat, pavarësisht se cilit ankand “Shadow” dhe për cilin kufi dhe drejtim të zonës së ofertimit janë dorëzuar. Në rast të ofertave të ndërlidhura me ankande të ndryshme dhe të mbivendosura, Platforma e Alokimit do të konsiderojë të gjitha detyrimet maksimale të llogaritura të pagesës si detyrime pagese të papaguara sipas nenit 21.
5. Për llogaritjen e detyrimeve maksimale të pagesës në lidhje me kufirin dhe drejtimin e zonës së ofertimit, Platforma e Alokimit do të rendis ofertat e regjistruara të një pjesëmarrësi të regjistruar sipas çmimit të ofertës në rend zbritës (rendit meritator). Oferta 1 do të jetë oferta me çmimin e ofertës më të lartë dhe oferta n do të jetë oferta me çmimin e ofertës më të ulët. Platforma e Alokimit do të llogarisë detyrimet maksimale të pagesës sipas ekuacionit të mëposhtëm:

$$MPO = \sum_{hours} MAX \left[BidPrice(1) * BidQuantity(1); BidPrice(2) * \sum_{i=1}^2 BidQuantity(i); \dots \dots; BidPrice(n-1) * \sum_{i=1}^{n-1} BidQuantity(i); BidPrice(n) * \sum_{i=1}^n BidQuantity(i) \right]$$

6. Gjatë llogaritjes së detyrimeve maksimale të pagesës sipas paragrafit 5 të këtij neni, Platforma e Alokimit do të marrë parasysh edhe rritjen e detyrimeve maksimale të pagesës me tatimet dhe taksat e aplikueshme në fuqi, sipas nenit 48.

Neni 33

Përcaktimi i rezultateve të ankandit “Shadow”

1. Pas skadimit të periudhës së ofertimit për një ankand “Shadow” dhe verifikimit të limitit të kredisë në përputhje me nenin 32, platforma e alokimit do të përcaktojë rezultatet e ankandit “Shadow” dhe do të ndajë të drejtat ditore të transmetimit në përputhje me këtë nen.
2. Përcaktimi i rezultateve të ankandit “Shadow” do të përfshijë:
 - (a) Përcaktimin e sasisë totale të të Drejtave Ditore të Transmetimit të alokuara sipas kufirit dhe drejtimit të zonës së ofertimit;
 - (b) Identifikimin e ofertave fituese që janë plotësisht ose pjesërisht fituese; dhe
 - (c) Përcaktimin e kufirit dhe drejtimit të çmimit marginal për zonën e ofertimit.
3. Platforma e Alokimit do të përcaktojë rezultatet e ankandit “Shadow” duke përdorur një funksion optimizimi me synimin që të maksimizoj shumës e suficitit të pjesëmarrësve të regjistruar dhe të ardhurave të kongjestimit të gjeneruara nga ofertat fituese duke respektuar kufizimet e funksionit të optimizimit në formën e kapaciteteve përkatëse të ofruara. Platforma e Alokimit do të publikojë në faqen e saj të internetit informacion shtesë shpjegues mbi funksionin e optimizimit të algoritmit.
4. Platforma e alokimit do të përcaktojë çmimin marginal në çdo kufi të zonës së ofertimit dhe në bazë të drejtimit mbi kriteret e mëposhtme:
 - (a) Nëse sasia totale e Kapacitetit Ndërzonal për të cilin janë dorëzuar ofertat e vlefshme është më e ulët ose e barabartë me Kapacitetin përkatës të Ofruar për ankandin përkatës “Shadow”, atëherë çmimi marginal do të jetë zero;

- (b) Nëse sasia totale e Kapacitetit Ndërzonal për të cilin janë dorëzuar ofertat e vlefshme tejkalon kapacitetin përkatës të ofruar për ankandin përkatës "Shadow", çmimi marginal do të përcaktohet në çmimin(et) më të ulët të ofertës(ve) të alokuara plotësisht ose pjesërisht duke përdorur Kapacitetet përkatëse të Ofruara.
5. Nëse dy (2) ose më shumë pjesëmarrës të regjistruar kanë dorëzuar oferta të vlefshme me të njëjtin çmim për një kufi dhe drejtim të Zonës së Ofertimit, që nuk mund të pranohen plotësisht për sasinë totale të kërkuar të të Drejtave Ditore të Transmetimit, Platforma e Alokimit do të përcaktojë ofertat fituese dhe sasinë e të drejtave ditore të transmetimit të alokuara për pjesëmarrës të regjistruar si më poshtë:
- (a) Kapaciteti ndërzonal i disponueshëm për ofertat që përcakton çmimin marginal do të ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet numrit të pjesëmarrësve të regjistruar që kanë dorëzuar këto oferta;
- (b) në rast se sasia e të Drejtave Ditore të Transmetimit të kërkuara nga një Pjesëmarrës i Regjistruar me Çmim Margjinal është më e ulët ose e barabartë me pjesën e llogaritur sipas pikës (a) më sipër, kërkesa e këtij pjesëmarrësi të regjistruar do të plotësohet plotësisht;
- (c) nëse sasia e kërkuar e të Drejtave Ditore të Transmetimit nga një Pjesëmarrës i Regjistruar me Çmimin Margjinal tejkalon pjesën e llogaritur sipas pikës (a) më sipër, kërkesa e këtij pjesëmarrësi të regjistruar do të plotësohet deri në shumën e pjesës së llogaritur sipas pikës (a) më sipër;
- (d) çdo Kapacitet Ndërzonal i mbetur pas alokimit sipas pikave (b) dhe (c) do të ndahet me numrin e pjesëmarrësve të regjistruar, kërkesat e të cilëve nuk janë plotësuar plotësisht dhe nuk u janë flokuar atyre duke zbatuar procesin e përshkruar në pikat (a), (b) dhe (c) më sipër;
- (e) çdo Kapacitet Ndërzonal i mbetur pas alokimit sipas pikës (d), do të alokohet duke përdorur kriteret e paraqitjes kronologjike (vula kohore).
6. Sa herë që llogaritja e përcaktuar në paragrafët 3 deri në 5 të këtij neni nuk rezulton në një sasi të plotë MË në përputhje me nenin 28 paragrafi 1(f), të drejtat ditore të transmetimit do të rrumbullakosen në MË të plotë më të afërt. Rasti kur të drejtat ditore të transmetimit të alokuara për pjesëmarrës individualë të regjistruar janë të barabarta me zero pas rrumbullakimit nuk do të ndikojë në përcaktimin e çmimit marginal.

Neni 34

Njoftimi i rezultateve të ankandit "Shadow"

1. Të drejtat e transmetimit konsiderohen se i janë alokuar një pjesëmarrësi të regjistruar që nga momenti kur pjesëmarrësi i regjistruar është informuar për rezultatet dhe kur është e aplikueshme, **më së voni 1 orë** pasi rezultatet provizionale të ankandit "Shadow" janë njoftuar në përputhje me këtë nen.
2. Platforma e Alokimit do të publikojë në faqen e saj të internetit rezultatet e ankandit "Shadow" sapo që ndarja TË deklarohet përfundimisht, por jo më vonë se ora **1:45 pasdite** në ditën para dërgimit dhe përcaktimit të rezultateve të ankandit "Shadow" sipas nenit 33. Për ankandet "Shadow" që dihen paraprakisht, rezultatet do të publikohen në përputhje me nenin 27.
3. Publikimi i rezultateve të ankandit "Shadow" për çdo kufi të zonës së ofertimit dhe orë të ditës të përfshira në ankand do të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:

- (a) gjithsej të drejtat e kërkuara ditore të transmetimit në MË;
 - (b) gjithsej të drejtat ditore të alokuara të transmetimit në MË;
 - (c) Çmimi marginal në Euro/MË për orë;
 - (d) Numrin e pjesëmarrësve të regjistruar që marrin pjesë në ankand "Shadow";
 - (e) Listën e emrave dhe numrit të pjesëmarrësve të regjistruar që kanë vendosur të paktën një ofertë fituese në ankand "Shadow";
 - (f) Listën e ofertave të regjistruara pa identifikimin e pjesëmarrësve të regjistruar (kurba e ofertës); dhe
 - (g) Të ardhura nga kongjestioni nga ankandet "Shadow" për kufirin e zonës së ofertimit.
4. Në të njëjtën kohë me publikimin e rezultateve të ankandit në hije, platforma e alokimit do të njoftojë nëpërmjet mjetit të ankandit çdo pjesëmarrës të regjistruar që ka dorëzuar një ofertë në një ankand hije specifik për çdo kufi të zonës së ofertimit të përfshirë në ankand hije të paktën të dhënat e mëposhtme:
- (a) të drejtat ditore të transmetimit të alokuara për çdo orëtë periudhës së produktit në MË;
 - (b) Çmimi marginal në Euro/MË për orë; dhe
 - (c) shuma e duhur për të Drejtat Ditore të Transmetimit të alokuara në Euro(€), i rrumbullakosur në dy shifra dhjetore; dhe
 - (d) CAI i është caktuar të Drejtave Ditore të Transmetimit të alokuara.
5. Nëse Mjeti i Ankandit nuk është në dispozicion, Platforma e Alokimit do të informojë pjesëmarrësit e regjistruar për rezultatet e ankandit "Shadow" në përputhje me KAPITULLIN 6.
6. Pjesëmarrësit e regjistruar do të kontrollojnë rezultatet e ankandit "Shadow" dhe, aty ku është e arsyeshme, mund të kontestojnë rezultatet e ankandit "Shadow" brenda periudhës së kontestimit të përcaktuar në Specifikimin e Ankandit. Platforma e Alokimit do të marrë në konsideratë kontestimin vetëm kur pjesëmarrësi i regjistruar arrin të demonstrojë gabimin nga Platforma e Alokimit në rezultatet e ankandit "Shadow".
7. Pjesëmarrësi i regjistruar mund të kontestojë rezultatet e ankandit "Shadow" brenda afatit të përcaktuar në Specifikimin përkatës të Ankandit.
8. Kontestimi do t'i njoftohet Platformës së Alokimit dhe do të titullohet si "kontestim".
9. Çdo kontestim duhet të përmbajë sa vijon:
- (a) Datën e kontestimit;
 - (a) identifikimin e ankandit "Shadow" të kontestuar;
 - (b) identifikimin e pjesëmarrësit të regjistruar;
 - (c) emrin, adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit të pjesëmarrësit të regjistruar;

(d) përshkrimin e detajuar të fakteve dhe arsytet e kontestimit; dhe

(e) dëshminë e rezultateve të gabuara të ankandit “Shadow”;

10. Platforma e Alokimit do t'i përgjigjet pjesëmarrësit të regjistruar jo më vonë se **1 orë** pasi rezultatet provizionale të ankandit “Shadow” tu jenë njoftuar pjesëmarrësve të regjistruar.

Nëse nuk merret asnjë kontestim brenda afatit të përcaktuar në specifikimet përkatëse të ankandit, rezultatet provizionale të ankandit “Shadow” do të publikohen si përfundimtare dhe do të jenë në dispozicion në faqen e internetit të Platformës së Alokimit.

KAPITULLI 5

Përdorimi i të Drejtave të Transmetimit

Neni 35

Parimet e përgjithshme

1. Të drejtat e transmetimit fizik të shpërndara në ankand “Shadow” do t'i nënshtrohen parimit “Përdore ose Humbe” (ang. Use it or Lose It).
2. Mbajtësi i të drejtave të transmetimit fizik të alokuara mund të dominoj të drejtat e transmetimit fizik për përdorim e tyre fizik në përputhje me nenin 36.

Neni 36

Nominimi i të drejtave të transmetimit fizik

1. Personat që kanë të drejtë të nominojnë të drejtat e transmetimit fizik duhet të përmbushin kërkesat e përshkruara në rregullat në fuqi për nominim. Personat e kualifikuar mund të jenë si më poshtë:
 - (a) mbajtësi i të drejtave të transmetimit fizik;
 - (b) personi i njoftuar nga mbajtësi i të drejtave fizike të transmetimit gjatë procesit të nominimit tek operatorët përkatës të sistemit të transmetimit në përputhje me rregullat përkatëse të nominimit;
2. Platforma e Alokimit do të ofrojë në faqen e saj të internetit një përmbledhje të opsioneve të renditura në paragrafin 1 të këtij neni të cilat janë të zbatueshme në çdo kufi të zonës së ofertimit.
3. Nominimi do të bëhet në përputhje me dokumentin e të drejtave.
4. Platforma e Alokimit do të publikojë një listë me rregullat përkatëse të nominimit për kufijtë e zonës së ofertimit në faqen e saj të internetit.
5. Afatet e nominimit për kufijtë përkatës të zonës së ofertimit përcaktohen në rregullat përkatëse të nominimit. Platforma e Alokimit do të publikojë informacione në faqen e saj të internetit mbi afatet e nominimit për kufirin e zonës së ofertimit. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet afateve të publikuara nga Platforma e Alokimit dhe atyre të rregullave të vlefshme dhe ligjërish të detyrueshme përkatëse të nominimit, këto të fundit do të mbizotërojnë dhe Platforma e Alokimit nuk do të mbahet përgjegjëse për ndonjë dëmtim për shkak të një mospërputhjeje të tillë.

Neni 37

Dokumenti i të Drejtave

1. Dokumenti i të drejtave do të përmbajë informacionet në lidhje me vëllimin në **MË** që personat e kualifikuar kanë të drejtë të nominojnë në kufijtë dhe udhëzimet specifike të zonës së ofertimit dhe për periudha të orës.

2. Platforma e Alokimit do të dërgojë dokumentin e të drejtave çdo ditë dhe jo më vonë se tridhjetë (30) minuta pasi rezultatet e ankandit “Shadow” t'i jenë njoftuar pjesëmarrësit të regjistruar te personi i kualifikuar sipas nenit 36 paragrafi 1 (a).

Neni 38

Rezervimi i të drejtave të transmetimit fizik për shërbimet e balancimit

Të drejtat e transmetimit fizik të fituara në ankandet “Shadow” nuk do të jenë subjekt i rezervimit për shërbimet e balancimit.

KAPITULLI 6

Procedurat “rezervë” (fallback)

Neni 39

Dispozitat e përgjithshme

1. Platforma e Alokimit do të organizojë, për atë që është arsyeshmërisht e praktikueshme, një procedurë rezervë në rastet e mëposhtme të dështimit të një procesi standard:
 - (a) nëse teknikisht nuk është e mundur të mbahet një ankand “Shadow”, për shembull në rastet e mëposhtme:
 - nëse teknikisht nuk është e mundur të përdoret procedura standarde e shkëmbimit të të dhënave; ose
 - në rast se Platforma e Alokimit përballlet me pengesa teknike gjatë procesit të ankandit “Shadow”; ose
 - (b) në rast të rezultateve të gabuara për shkak të llogaritjes së gabuar të çmimit marxhinal; ose
 - (c) në rast të ndarjes së gabuar të të drejtave të transmetimit ditor për pjesëmarrësit e regjistruar ose arsye të ngjashme.
2. Platforma e Alokimit mund të përdorë një ose të gjitha procedurat e mëposhtme rezervë:
 - (a) prezantimi i një procedure rezervë për shkëmbimin e të dhënave sipas nenit 40;
 - (b) prezantimi i procedurës rezervë për ankand “Shadow” sipas nenit 41;
 - (c) një tjetër procedurë shtesë rezervë në baza *ad hoc* nëse konsiderohet e përshtatshme nga Platforma e Alokimit për tejkalimin e pengesave teknike.
3. Platforma e Alokimit, për atë që është e mundur dhe pa vonesa të panevojshme, do të informojë pjesëmarrësit e regjistruar për devijimet e mundshme nga proceset standarde dhe aplikimin e një procedure rezervë nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit dhe duke përdorur mjetin e ankandit.
4. Pjesëmarrësit e regjistruar do të informojnë menjëherë platformën e alokimit për çdo problem të vërejtur me përdorimin e mjetit të ankandit dhe të gjitha pasojat e mundshme nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Në rast të një problemi urgjent, i cili do të zgjidhet menjëherë dhe i cili identifikohet gjatë orarit të punës, pjesëmarrësi i regjistruar do të telefonojë menjëherë platformën e alokimit në numrin e telefonit të treguar në faqen e internetit të platformës së alokimit për këtë lloj problemi. Platforma e Alokimit do të konfirmojë marrjen e problemit dhe do të informojë pjesëmarrësit e regjistruar për statusin e problemit sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 40

Procedura rezervë për shkëmbimin e të dhënave

1. Në rast të një dështimi të proceseve standarde në faqen e Platformës së Alokimit për shkëmbimin e të dhënave nëpërmjet mjetit të ankandit, siç përshkruhet në këto rregulla të alokimit “Shadow”, Platforma e Alokimit mund të informojë pjesëmarrësit e regjistruar që një

procedurë rezervë për shkëmbimin e të dhënave mund të përdoret si më poshtë:

- (a) brenda afateve të zbatueshme, përveç nëse njoftohet ndryshe nga platforma e alokimit, pjesëmarrësi i regjistruar, nëpërmjet mjeteve elektronike, siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit, do të kërkojë të futë të dhënat përkatëse në mjetin e ankandit duke përdorur këtë procedurë rezervë për shkëmbimin e të dhënave;
 - (b) në bazë të kërkesës, pjesëmarrësi i regjistruar do t'i sigurojë platformës së alokimit të dhënat përkatëse që do të futen në mjetin e ankandit në formatin e specifikuar në rregullat e sistemit të informacionit;
 - (c) Platforma e Alokimit do të vendosë të dhënat e paraqitura në mjetin e ankandit;
 - (d) Platforma e Alokimit në rregullat e sistemit të informacionit mund të vendosë një proces identifikimi për pjesëmarrësin e regjistruar në momentin kur pjesëmarrësi i regjistruar dorëzon të dhënat përkatëse operative ose tregtare dhe i kërkon platformës së alokimit t'i fusë këto të dhëna në mjetin e ankandit në emër të saj me mjetet e procedurës rezervë. Nëse pjesëmarrësi i regjistruar ose personi i autorizuar nga pjesëmarrësi i regjistruar për këtë qëllim nuk identifikohet qartë, Platforma e Alokimit do të ketë të drejtë të mos kryejë futjen e të dhënave;
 - (e) pjesëmarrësi i regjistruar do t'i sigurojë platformës së alokimit një numër telefoni, i cili mund të përdoret në rast se komunikimi është nevojshëm;
 - (f) pasi që Platforma e Alokimit të ketë futur të dhënat e ofruara në mjetin e ankandit në emër të pjesëmarrësit të regjistruar, Platforma e Alokimit do të informojë pjesëmarrësin e regjistruar, pa vonesë të panevojshme, përmes telefonit dhe/ose nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit; dhe
 - (g) Platforma e Alokimit në asnjë rrethanë nuk mban përgjegjësi nëse nuk arrin të kontaktoj pjesëmarrësin e regjistruar përmes mjeteve të komunikimit të mësipërm.
2. Në rast të aplikimit të procedurës rezervë për shkëmbimin e të dhënave, të gjitha informacionet e nevojshme që vihen në dispozicion nëpërmjet mjetit të ankandit gjatë proceseve standarde mund t'u shpërndahen pjesëmarrësve të regjistruar nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit, ose kur është e përshtatshme, të publikuara në faqen e internetit të platformës së alokimit.

Neni 41

Procedura e tërheqjes për ankandin "Shadow"

1. Pasi të jetë hapur periudha e ofertimit, platforma e alokimit:
 - (a) Aty ku është arsyeshmërisht e praktikueshme, do të shtyjë fundin e periudhës së ofertimit duke njoftuar pjesëmarrësit e regjistruar për afatet e rishikuara në specifikimin e ankandit; ose
 - (b) do të anulojë ankandin fillestar sipas nenit 43; dhe do të organizojë një ankand të ri për të njëjtën periudhë produkti; ose
 - (c) do të zbatojë ankandin rezervë, siç përcaktohet në nenin 42.

2. Nëse procedura rezervë e përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni nuk mund të zbatohet për të njëjtën periudhë të produktit, kapacitetet përkatëse ndërzonale do të ofrohen në procesin pasues të alokimit të kapaciteteve.

Neni 42
Ankandi rezervë

1. Nëse platforma e alokimit, pas publikimit të specifikimeve të ankandit, nuk është në gjendje të mbajë proceset e ankandit "Shadow" për arsyet e renditura në nenin 39, paragrafi 1, Platforma e Alokimit do t'u dërgojë njoftimin të gjithë pjesëmarrësve të regjistruar për aplikimin e ankandit rezervë, sa më shpejt që është e mundur dhe jo më vonë se ora 13:45 në ditën para ditës së dorëzimit.
2. Në rast të një ankandi rezervë, do të merren parasysh vetëm ofertat e paracaktuara për ankandin rezervë, në përputhje me nenin 31. Nëse sasia e ofertës së paracaktuar ose një sasi e llogaritur si shumë e sasive të ofertës për disa oferta të paracaktuara të paraqitura për të njëjtin ankand "Shadow" e tejkalon kapacitetin përfundimtar të ofruar, sasia e ofertës do të zvogëlohet për të qenë e barabartë me kapacitetin e ofruar.
3. Kapaciteti i ofruar ndahet në pjesë proporcionale ndërmjet pjesëmarrësve të regjistruar.
4. Çmimi marginal i të drejtave të transmetimit ditor është 0 €/MËh. Vlera e të drejtave të transmetimit ditor do të rrumbullakohet në MË të plotë më të afërt.
5. Pjesëmarrësit e regjistruar do të njoftohen për rezultatet deri në orën **13:50**, në D-1.

Neni 43
Anulimi i ankandit "Shadow"
(hije)

1. Nëse Platforma e Alokimit anulon një ankand "Shadow", të gjitha ofertat tashmë të dorëzuara dhe rezultatet e ankandit përkatës do të konsiderohen të pavlefshme.
2. Platforma e Alokimit do të informojë të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar pa vonesë të panevojshme, për anulimin e ankandit me një njoftim të publikuar në mjetin e ankandit ose në faqen e internetit të platformës së alokimit si dhe me email.
3. Anulimi i ankandit "Shadow" mund të shpallet në rastet e mëposhtme:
 - (a) përpara se kapaciteti ndërzonal të konsiderohet i alokuar në rast se Platforma e Alokimit përballet me pengesa teknike gjatë procesit të ankandit "Shadow" si dështimi i proceseve standarde dhe procedurave rezervë ose arsyeve të ngjashme; dhe
 - (b) gjatë periudhës së kontestimit, në rast të rezultateve të gabuara për shkak të llogaritjes së gabuar të çmimit marginal ose alokimit të gabuar të të drejtave të transmetimit për pjesëmarrësit e regjistruar ose arsye të ngjashme.
4. Në rast të anulimit të ankandit "Shadow" para publikimit përfundimtar të rezultateve të ankandit "Shadow", pjesëmarrësve të regjistruar nuk do t'u paguhet asnjë kompensim.

5. Platforma e Alokimit do të publikojë në faqen e saj të internetit, pa vonesë të panevojshme, arsyet e anulimit të ankandit “Shadow”.
6. Dispozitat e nenit 43 mund të zbatohen edhe për një ankand rezervë (në rast të rezultateve të gabuara).

KAPITULLI 7

Kufizimi

Neni 44

Ngjarjet aktivizuese dhe pasojat e kufizimit të të Drejtave të Transmetimit Ditor

1. Të drejtat e transmetimit ditor mund të kufizohen vetëm në rast të një fuqie madhore ose një situatë emergjente.
2. Kufizimi mund të zbatohet për të drejtat e alokuara të transmetimit ditor, duke përfshirë të drejtat e nominuara të transmetimit fizik, kur është e nevojshme.
3. Çdo pjesëmarrës i regjistruar i prekur nga kufizimi do të humbasë të drejtën e tij për të nominuar për përdorim fizik të drejtat përkatëse të transmetimit fizik nëse kjo e drejtë ekziston në momentin e kufizimit.
4. Në rast kufizimi, pjesëmarrësi i regjistruar i prekur nuk ka të drejtë të marrë ndonjë rimbursim ose kompensim në lidhje me kufizimin ose si pasojë e tij.

Neni 45

Procesi dhe njoftimi i kufizimit

Në të gjitha rastet, kufizimi do të kryhet nga një ose më shumë operatorë të sistemit të transmetimit në kufirin e zonës ofertuese ku janë ndarë të drejtat e transmetimit ditor.

KAPITULLI 8

Faturimi dhe pagesa

Neni 46

Parimet e përgjithshme

1. Një pjesëmarrës i regjistruar do të paguajë shumat e papaguara siç janë llogaritur në përputhje me nenin 47 për të gjitha të drejtat e transmetimit që i janë alokuar.
2. Pjesëmarrësi i Regjistruar pas pagesës mund të përdorë kapacitetin ndërzonat të lidhur me të drejtat e transmetimit të alokuara siç përshkruhet vetëm në këto rregulla të alokimit "Shadow". Çdo e drejtë për përdorim fizik të sistemit të transmetimit mund t'i nënshtrohet marrëveshjeve të veçanta ndërmjet pjesëmarrësit të regjistruar dhe operatorëve përkatës të sistemit të transmetimit.
3. Të gjitha informacionet financiare, çmimet dhe shumat e papaguara do të shprehen në Euro (€), përveç nëse devijimet kërkohen nga ligji ose rregulloret në fuqi.
4. Pagesa do të bëhet në datën në të cilën shuma e dhënë është kredituar në llogarinë e përfituesit. Çfarëdo interesi për pagesë të vonuar do të konsiderohet si i shlyer në datën kur pagesa është kredituar nga llogaria e paguesit.
5. Pagesat do të bëhen në euro (€).
6. Platforma e Alokimit do të marrë në konsideratë tatimet dhe taksat në normën dhe në masën e zbatueshme kur vlerëson detyrimet e pagesave dhe të lëshojë faturat sipas këtyre rregullave të alokimit "Shadow" që janë nën nenin 48.
7. Pjesëmarrësi i regjistruar do t'i sigurojë platformës së alokimit informacionet përkatëse për të justifikuar nëse tatimet dhe taksat përkatëse janë ose jo të zbatueshme kur nënshkruhet marrëveshja e pjesëmarrjes, si dhe çdo ndryshim në këtë drejtim pa vonesa të panevojshme. Prandaj, është obligim i pjesëmarrësit të regjistruar të informojë platformën e alokimit për çdo tatim dhe taksë vendore, brenda ose jashtë komunitetit, që është në përputhje me legjislacionin e vendit të themelimit të pjesëmarrësit të regjistruar.

Neni 47

Llogaritja e shumave të papaguara

1. Pjesëmarrësit e regjistruar do të paguajnë për secilën nga të Drejtat e Transmetimit që u është alokuar atyre dhe për orë individuale një shumë të barabartë me:
 - (a) çmimin marginal (për MË në orë); shumëzuar me
 - (b) të drejtat e transmetimit ditore në MË të alokuara në orë individuale të ditës.
2. Të drejtat e transmetimit do të faturohen në baza mujore. Platforma e Alokimit do të llogarisë shumën që do të paguhet në mënyrë retroaktive për muajin paraardhës. Shuma e papaguar plus çdo tatim dhe taksë, ngarkesë ose tarifë tjetër e zbatueshme që i nënshtrohen nenit 48, do të rumbullakoset në dy shifra dhjetore.

Neni 48

Taksat bruto

1. Çdo pjesëmarrës i regjistruar duhet të kryejë të gjitha pagesat në lidhje me rregullat e alokimit

“Shadow” pa ndonjë zbritje tatimore, përveç rasteve kur zbritja tatimore kërkohet me ligj.

2. Nëse me ligj kërkohet që të bëhet zbritje tatimore nga pjesëmarrësi i regjistruar, shuma e pagesës që duhet bëhet nga pjesëmarrësi i regjistruar në platformën e alokimit do të rritet në një shumë që (pas zbritjes tatimore) lë një shumë të barabartë me pagesën e cila do të ishte realizuar nëse nuk do të ishte kërkuar zbritja tatimore.
3. Paragrafi 2 i këtij neni nuk zbatohet në lidhje me çfarëdo tatimi të vlerësuar në platformën e alokimit për çdo pagesë të marrë në lidhje me rregullat e alokimit “Shadow” sipas ligjeve të juridiksionit në të cilin është përfshirë Platforma e Alokimit ose, nëse është e ndryshme, juridiksionit (ose juridiksioneve) në të cilat Platforma e Alokimit trajtohet si rezidente për qëllime tatimore, apo për qëllime tatimore ka ose konsiderohet të ketë një seli të përhershme ose një vend të caktuar biznesi, të cilit i atribuohet çdo pagesë sipas rregullave të alokimit “Shadow”. Paragrafi 2 i këtij neni nuk zbatohet për tatimin mbi vlerën e shtuar (siç parashikohet në direktivën e TVSH-së 2006/112/KE ose, siç mund të jetë, çdo legjislacion i ngjashëm kombëtar, i ndryshuar herë pas here) dhe çfarëdo tatimi tjetër të një natyre të ngjashme.

Neni 49

Faturimi dhe kushtet e pagesës

1. Platforma e Alokimit do të lëshojë fatura për pagesat për të gjitha të drejtat e transmetimit të alokuara në përputhje me këto rregulla të alokimit “Shadow” në baza mujore dhe jo më vonë se dita e dhjetë (10) e punës e çdo muaji për ankandet “Shadow” të muajit paraardhës.
2. Faturat do të lëshohen për pagesat e mëposhtme:
 - (a) shumën e duhur të përcaktuar në nenin 47(2);
 - (b) çfarëdo tatimi dhe takse përkatëse që i nënshtrohet neni 48.
3. Platforma e Alokimit do të dërgojë faturën tek pjesëmarrësi i regjistruar, përmes mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit, në emailin e personit kontaktues financiar të dorëzuar në përputhje me nenin 8 (1)(h) ose duhet ta vërë në dispozicion për pjesëmarrësin e regjistruar nëpërmjet mjetit të ankandit. Data e lëshimit të faturës do të jetë data në të cilën fatura është dërguar përmes mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit ose data kur fatura vihet në dispozicion nëpërmjet mjetit të ankandit nëse kjo bëhet gjatë orarit të punës apo të nesërmen, nëse dërgohet pas orarit të punës.
4. Pagesat e papaguara mund të jenë në formë neto nga platforma e alokimit, duke marrë parasysh shumën e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, dhe çdo shumë tjetër të pagueshme nga Platforma e Alokimit për pjesëmarrësin e regjistruar, si rezultat i proceseve të alokimit të kryera nga platforma e alokimit.
5. Pjesëmarrësi i regjistruar do t'i kryejë detyrimet e pagesës që rrjedhin nga paragrafi 2 ose paragrafi 4 i këtij neni, brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së lëshimit të faturës.
6. Pagesat nga pjesëmarrësi i regjistruar siç përcaktohen në paragrafin 5 të këtij neni do të paguhet në llogarinë e biznesit të platformës së alokimit të specifikuar në faturë duke treguar referencën e faturës, ose në mënyrë alternative, Platforma e Alokimit do të mbledhë pagesën automatikisht nga llogaria e dedikuar e biznesit të pjesëmarrësit të regjistruar në datën përkatëse në faturë.

7. Platforma e Alokimit do t'i shlyejë detyrimet e saj të pagesës që rrjedhin nga paragrafi 4 i këtij neni brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas datës së pranimit të faturës, duke paguar shumën në llogarinë bankare siç është njoftuar gjatë procesit të anëtarësimit në përputhje me nenin 8 paragrafi 1(g) nga pjesëmarrësi i regjistruar i cili ka të drejtën e pagesave në datën e caktuar.
8. Me mbledhjen e pagesës siç përcaktohet në paragrafin 6 të këtij neni, Platforma e Alokimit do të përditësojë limitin e kredisë në përputhje me rrethanat.
9. Në rast të një fature të gabuar që rezulton në një pagesë shtesë të platformës së alokimit ose pjesëmarrësit të regjistruar, Platforma e Alokimit do të korrigjojë faturën dhe çdo shumë e caktuar do të shlyhet sapo t'i jetë njoftuar pjesëmarrësit të regjistruar.
10. Të gjitha tarifat bankare do të mbulohen nga pjesëmarrësi i regjistruar.
11. Pjesëmarrësi i regjistruar nuk do të ketë të drejtë të kompensojë asnjë shumë, ose të mbajë në burim ndonjë borxh që lind në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga një ankand "Shadow", kundrejt çdo padie ndaj platformës së alokimit, pavarësisht nëse lindin ose jo nga një ankand. Megjithatë, e drejta për kompensim dhe e drejta për të mbajtur në burim nuk përjashtohen në rast se padia e pjesëmarrësit të regjistruar kundër platformës së alokimit vendoset nga një vendim ligjërishit i detyrueshëm ose është i pakontestueshëm.

Neni 50

Mosmarrëveshjet mbi pagesën

1. Një pjesëmarrës i regjistruar mund të kundërshtojë shumën e një fature, duke përfshirë çdo shumë që duhet t'i kreditohet pjesëmarrësit të regjistruar. Në këtë rast, pjesëmarrësi i regjistruar do të njoftojë natyrën e mosmarrëveshjes dhe shumën në mosmarrëveshje platformës së shpërndarjes sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas datës së lëshimit të faturës ose notës së kreditit nga posta e regjistruar dhe mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Përtej kësaj periudhe, fatura do të konsiderohet se është pranuar nga pjesëmarrësi i regjistruar.
2. Nëse pjesëmarrësi i regjistruar dhe Platforma e Alokimit nuk janë në gjendje të zgjidhin dallimin brenda dhjetë (10) ditëve pune pas njoftimit, do të zbatohet procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 54.
3. Një mosmarrëveshje në lidhje me shumën e një fature në asnjë mënyrë nuk do ta lirojë palën nga detyrimi për të paguar shumën e tilla që duhet të paguhet në përputhje me nenin 49.
4. Nëse në bazë të procedurës për zgjidhjet të mosmarrëveshjeve siç parashikohet në nenin 54 është dakorduar ose përcaktuar që një shumë e paguar ose e marrë nga pjesëmarrësi i regjistruar nuk ishte e pagueshme siç duhet, do të zbatohet procesi i mëposhtëm:
 - (a) Platforma e Alokimit do të kthejë çdo shumë duke përfshirë interesin që do të llogaritet sipas nenit 46(4) pjesëmarrësit të regjistruar në rast se shuma e paguar nga pjesëmarrësi i regjistruar siç përcaktohet në nenin 49(5) ishte më e lartë ose shuma e paguar nga Platforma e Alokimit ishte më e ulët se shuma e duhur. Platforma e Alokimit do të bëjë pagesën në llogarinë bankare të treguar nga pjesëmarrësi i regjistruar për këtë rimbursim në përputhje me nenin 8 paragrafi 1(g).
 - (b) pjesëmarrësi i regjistruar do të paguajë çdo shumë duke përfshirë interesin që do të llogaritet sipas nenit 46(4) në platformën e shpërndarjes në rast se shuma e paguar nga

pala e regjistruar siç përcaktohet në nenin 49(5) ishte më e ulët ose shuma e paguar nga Platforma e Alokimit ishte më e lartë se shuma e duhur. Pjesëmarrësi i regjistruar do të bëjë pagesën në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 49(6). Me një pagesë të tillë, Platforma e Alokimit do të përditësojë limitin e kreditit të pjesëmarrësit të regjistruar siç përcaktohet në nenin 49 (8).

5. Interesi i paguar në rast të pagesës në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni do të aplikohet nga dita e parë (1) pas datës në të cilën pagesa është bërë deri në datën në të cilën shuma e kontestuar është rimbursuar dhe do të zbatohet edhe për të gjitha tatimet dhe taksat e kërkuara me ligj.

Neni 51

Pagesë me vonesë dhe incident pagese

1. Në rast se pjesëmarrësi i regjistruar nuk ka paguar plotësisht një faturë deri në datën e caktuar në faturë, Platforma e Alokimit do të njoftojë pjesëmarrësin e regjistruar se një incident pagese do të regjistrohet nëse shuma që përfshin interesin e aplikueshëm nuk merret brenda tre (3) ditëve të punës pas dërgimit të njoftimit. Në rast se nuk ka pagesë brenda afatit, Platforma e Alokimit do të njoftojë pjesëmarrësin e regjistruar se incidenti i pagesës është regjistruar.
2. Menjëherë pas regjistrimit të incidentit të pagesës, Platforma e Alokimit mund të përdorë kolateralet.
3. Platforma e Alokimit mund të pezullojë ose të përfundojë marrëveshjen e pjesëmarrjes në rast të incidentit të regjistruar të pagesës në përputhje me nenet 55 dhe 56.
4. Në rast të pagesës ose rimbursimit me vonesë, palët do të paguajnë interes mbi shumën e duhur, duke përfshirë taksat dhe tatimet nga dita e parë (1) pas datës në të cilën pagesa është dashur të kryhet deri në datën në të cilën është kryer pagesa. Interesi do të jetë i barabartë me shumën më të lartë të:
 - (a) një tarife fikse prej 100 €; ose
 - (b) tetë (8) pikë përqindjeje në vit mbi normën e interesit referencë të publikuar zyrtarisht nga autoritetet kombëtare të vendit në të cilin ndodhet Platforma e Alokimit dhe rrrumbullakosni deri në gjysmën e pikës më të afërt të përqindjes.

KAPITULLI 9

Të ndryshme

Neni 52

Kohëzgjatja dhe amendamenti i rregullave të alokimit "Shadow"

1. Rregullat e alokimit "Shadow" janë me kohëzgjatje të pacaktuar dhe i nënshtrohen amendamenteve në përputhje me këtë nen. Këto rregulla të alokimit "Shadow" dhe çdo amendament i tyre do të konsultohen sipas paragrafit 7 të këtij neni, të propozuara nga operatorët përkatës të sistemit të transmetimit dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me regjimin rregullator kombëtar në fuqi. Platforma e Alokimit do të publikojë rregullat e amendamentuara të shpërndarjes hije dhe do t'u dërgojë një njoftim ndryshimi pjesëmarrësve të regjistruar.
2. Sipas paragrafit 7 të këtij neni, një amendament do të hyjë në fuqi në datën dhe orën e specifikuar në njoftimin e amendamentit, por jo më herët se tridhjetë (30) ditë kalendrike pas dërgimit të njoftimit për amendament pjesëmarrësve të regjistruar nga platforma e alokimit.
3. Çdo amendament do të zbatohet për të gjitha aspektet e këtyre rregullave të shpërndarjes hije, duke përfshirë por pa u kufizuar në të gjitha ankandet hije të kryera pas datës në të cilën ndryshimi hyn në fuqi.
4. Përveç nëse shprehimisht theksohet ndryshe nga platforma e alokimit, rregullat e amendamentuara të alokimit "Shadow" do të rregullojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me këto rregulla, duke përfshirë ato të fituara përpara datës së amendamentit, por me datën e dorëzimit pas hyrjes në fuqi të amendamentit.
5. Çdo amendamentim i këtyre rregullave të alokimit "Shadow" do të zbatohet automatikisht për marrëveshjen e pjesëmarrjes në fuqi ndërmjet platformës së alokimit dhe pjesëmarrësit të regjistruar, pa qenë nevoja që pjesëmarrësi i regjistruar të nënshkruajë një marrëveshje të re pjesëmarrjeje, por pa cenuar të drejtën e pjesëmarrësit të regjistruar që të kërkojë përfundimin e marrëveshjes së tij të pjesëmarrjes në përputhje me nenin 56(1). Duke marrë pjesë në ankandin "Shadow" pasi që pjesëmarrësi i regjistruar është informuar për ndryshimet dhe/ose përshtatjet e rregullave të alokimit dhe pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve dhe/ose përshtatjeve të rregullave të alokimit, konsiderohet se pjesëmarrësi i regjistruar ka pranuar versionin e ndryshuar, pra versionin e vlefshëm dhe efektiv të rregullave të alokimit "Shadow".
6. Rregullat e alokimit "Shadow" do të rishikohen periodikisht nga platforma e alokimit, operatorët përkatës të sistemit të transmetimit të paktën çdo dy vjet që përfshijnë pjesëmarrësit e regjistruar. Në rast se operatorët përkatës të sistemit të transmetimit konsiderojnë ndryshimin e këtyre rregullave të alokimit "Shadow" si rezultat i këtij rishikimi, do të zbatohet procedura e përshkruar në këtë nen. Ky rishikim dyvjeçar nuk cenon kompetencën e autoriteteve kombëtare rregullatore për të kërkuar në çdo kohë ndryshime të rregullave të alokimit "Shadow" dhe shtojcave të përfshira në to në përputhje me legjislacionin ekzistues.
7. Këto rregulla të alokimit "Shadow" i nënshtrohen legjislacionit që mbizotëron në kohën kur ato hyjnë në fuqi. Në rast se ka një ndryshim në legjislacion ose ndonjë veprim nga autoritetet kompetente në nivel kombëtar, ose në nivel të Bashkimit Evropian, ose, siç mund të jetë, në nivel të Komunitetit të Energjisë, të cilat kanë ndikim në këto rregulla dhe/ose shtojcat e tyre më pas, pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e këtyre rregullave të "alokimit" Shadow, rregullat e do të ndryshohen në përputhje me rrethanat dhe në përputhje me këtë nen.

8. Lista e kufijve të zonës së ofertimit (shtojca 1) për të cilat zbatohen rregullat e alokimit "Shadow" mund të ndryshohet ose plotësohet në përputhje me dispozitat në lidhje me amendamentimin e rregullave të alokimit, ku për ndryshimin e kësaj liste kërkohet miratimi i një ose më shumë ARrK-ve.
9. Për qëllimin e përfshirjes së amendamentimit ose plotësimit, kërkohet konsultimi ose miratimi vetëm nga ARrK që ka juridiksion mbi OST-në përkatëse kufiri i zonës së ofertimit të së cilës është ndryshuar ose plotësuar, sipas nevojës.

Neni 53

Përgjegjësia

1. Platforma e Alokimit dhe pjesëmarrësit e regjistruar janë përgjegjës vetëm për përmbushjen e çdo detyrimi që ata marrin përsipër ose i nënshtrohen dhe që lind ose është në lidhje me rregullat e alokimit "Shadow" dhe marrëveshjen e pjesëmarrjes.
2. Varësisht nga çfarëdo dispozite tjetër e këtyre rregullave të alokimit "Shadow", Platforma e Alokimit do të jetë përgjegjëse vetëm për dëmet e shkaktuara nga:
 - (a) mashtrimi, neglizhenca e rëndë ose sjellja e pahijshme e qëllimshme.
 - (b) vdekja ose lëndimi personal që vjen nga neglizhenca e saj ose e punonjësve, agjentëve ose nënkontraktorëve të saj.
3. Një pjesëmarrës i regjistruar do të dëmshpërblejë dhe do të mbajë të zhdëmtuar platformën e alokimit dhe zyrtarët, punonjësit dhe agjentët e saj nga dhe kundër çfarëdo humbjeje ose detyrimi (përfshirë kostot ligjore) në lidhje me një dëm që ka shkaktuar, të cilin mund ta pësojë ose t'i ndodhë çdokujt prej tyre për shkak të padis nga ndonjë palë e tretë për humbje (qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë) të pësuar nga paraqitësi i kërkesës ose ndonjë nga zyrtarët, agjentët, nënkontraktorët ose punonjësit e paditësit në lidhje me këto rregulla të alokimit "Shadow".
4. Platforma e Alokimit dhe çdo pjesëmarrës i regjistruar pranon dhe pajtohet që mban përfitimet e paragrafit 3 të këtij neni për vete dhe si administrues i besuar dhe agjent për zyrtarët, punonjësit dhe agjentët e tij.
5. Pjesëmarrësi i regjistruar do të jetë përgjegjës vetëm për pjesëmarrjen e tij në ankandet "Shadow" duke përfshirë por pa u kufizuar në rastet e mëposhtme:
 - (a) Arritjen me kohë të ofertave dhe njoftimeve të transferimit dhe kthimit nga pjesëmarrësi i regjistruar;
 - (b) dështimin teknik të sistemit të informacionit nga ana e pjesëmarrësit të regjistruar duke penguar komunikimin përmes kanaleve të parashikuara në përputhje me këto rregulla të alokimit.
6. Në rast të kompensimit të kufizimit për shkak të fuqisë madhore ose situatës emergjente në përputhje me nenin 44, pjesëmarrësit e regjistruar nuk kanë të drejtë për kompensim tjetër përveç kompensimit të përshkruar në këto rregulla të alokimit "Shadow".
7. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të jetë përgjegjës në lidhje me çdo sanksion, gjobë ose tarifë që mund të vendoset nga autoritetet financiare në platformën e shpërndarjes për trajtimin e gabuar tatimor për shkak të informacionit të gabuar ose jo të plotë të dhënë nga pjesëmarrësi i regjistruar.

8. Ky nen i mbijeton përfundimit të marrëveshjes së pjesëmarrjes së pjesëmarrësit të regjistruar.

Neni 54

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Pa cenuar paragrafët 6 dhe 8 të këtij neni, kur ka një mosmarrëveshje, Platforma e Alokimit dhe Pjesëmarrësi i Regjistruar së pari do të kërkojnë zgjidhje miqësore nëpërmjet konsultimit të ndërsjellë në përputhje me paragrafin 2. Për këtë qëllim, Pala që ngre mosmarrëveshjen do të dërgojë një njoftim për palën tjetër duke treguar:
 - (a) Ekzistimin e Marrëveshjes për Pjesëmarrje mes palëve;
 - (b) Arsyen e mosmarrëveshjes; dhe
 - (c) Propozimin për një takim të ardhshëm, qoftë në formë fizike apo ndryshe, me qëllim të zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes.
2. Palët do të takohen brenda njëzet (20) ditësh pune pasi që çështja t'u jetë referuar atyre dhe do të kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Nëse nuk arrihet marrëveshja ose nuk merret asnjë përgjigje brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditëve të punës nga data e njoftimit të lartpërmendur, cilado palë mund t'ia referojë çështjen menaxhmentit të lartë të Palëve që të zgjidhin mosmarrëveshjen në përputhje me paragrafin 3.
3. Përfaqësuesit e lartë të Platformës së Alokimit dhe Pjesëmarrësit të Regjistruar me kompetencën për zgjidhje të mosmarrëveshjes do të takohen brenda njëzet (20) ditëve të punës nga dita e kërkesës për takim dhe do të mundohen të zgjidhin mosmarrëveshjen. Nëse përfaqësuesit nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen brenda njëzet (20) ditëve të punës nga takimi ose një kohe më të gjatë të dakorduar, atëherë mosmarrëveshja do të vendoset nga arbitrazhi në përputhje me paragrafin 4.
4. Kur një mosmarrëveshje i referohet arbitrazhit sipas paragrafit 3, qoftë Platforma e Alokimit ose Pjesëmarrësi i Regjistruar mund të njoftojë tjetrin duke deklaruar natyrën e mosmarrëveshjes dhe duke e referuar mosmarrëveshjen në arbitrazh. Arbitrazhi do të zhvillohet në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Odës Ekonomike (ICC). Arbitrazhi do të kryhet para një (1) arbitri që do të emërohet me marrëveshje të palëve, përveç nëse njëra palë kërkon emërimin e tre (3) arbitrave. Në rastin e arbitrazhit me një (1) arbitër, Palët do të bien dakord për emërimin e arbitrit brenda dy (2) muajve pas njoftimit të dhënë nga Pala që e dërgon mosmarrëveshjen në arbitrazh. Nëse nuk arrihet marrëveshje, arbitri do të caktohet nga Gjykata e ICC. Në rastin e arbitrazhit me tre (3) arbitra, paditësi do të emërojë një (1) arbitër dhe i padituri do të emërojë një (1) arbitër. Arbitrat e emëruar nga secila palë do të emërojnë më pas kryetarin e tribunalit të arbitrazhit brenda tre (3) ditëve të punës nga konfirmimi i emërimit të arbitrit të dytë nga i padituri. Nëse arbitrat e emëruar nga secila palë nuk mund të bien dakord për emërimin e kryetarit të arbitrazhit, kryetari caktohet nga Gjykata e ICC-së. Arbitrazhi do të zhvillohet në vendndodhjen e Platformës së Alokimit, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes dhe në përputhje me ligjin qeverisës të këtyre Rregullave të Alokimit "Shadow", ndërsa gjuha e procedurave të arbitrazhit do të jetë gjuha angleze. Nuk do të zbatohen dispozitat e arbitrazhit emergjent sipas Rregullave të Arbitrazhit të Odës Ekonomike, por do të zbatohen masat e përkohshme ose urgjente sipas ligjit në fuqi.
5. Vendimet e arbitrazhit do të jenë përfundimtare dhe detyruese për Platformën e Alokimit dhe Pjesëmarrësin përkatës të Regjistruar që nga data e marrjes së tyre. Platforma e Alokimit dhe Pjesëmarrësi i Regjistruar do të zbatojnë pa vonesë çfarëdo vendimi të arbitrazhit në lidhje me çdo mosmarrëveshje dhe secili heq dorë nga e drejta e tyre për apel ose mjet juridik para gjykatës ose autoritetit tjetër gjyqësor, për aq kohë sa kjo mund të të bëhet në mënyrë të vlefshme.

6. Pavarësisht nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, palët mund të dakordohen bashkërisht të zbatojnë procedurat gjyqësore në vend të arbitrazhit për të zgjidhur një mosmarrëveshje të lindur në lidhje me këto Rregulla të Alokimit "Shadow".
7. Në rastet e vonesës në pagesë dhe pavarësisht nga neni 51 dhe paragrafët 1 deri në 4 të këtij neni, një Palë mund të inicioj procedura gjyqësore kundër Palës tjetër për çdo shumë që duhet të paguhet sipas ose në lidhje me këto Rregulla të Alokimit "Shadow" dhe të cilat janë të papaguara për më shumë se njëzet (20) ditë pune pas datës kur shuma është dashur të paguhet.
8. Palët dakordohen që procedurat e referuara në paragrafët 6 ose 7 të këtij neni mund të iniciohen në çdo gjykatë kompetente për një kërkesë të tillë. Pjesëmarrësi i Regjistruar heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo kundërshtim që mund të ketë tani ose më vonë në lidhje me vendin e zhvillimit të procedurave të tilla para çfarëdo gjykate kompetente dhe nga çdo pretendim që procedura e tillë është ngritur në forum të papërshtatshëm.
9. Pavarësisht çfarëdo reference për zgjidhjen miqësore, zgjidhjen nga ekspertët ose arbitrazhin sipas këtij neni, Platforma e Alokimit dhe Pjesëmarrësi i Regjistruar do të vazhdojnë të kryejnë detyrimet e tyre përkatëse sipas këtyre Rregullave të Alokimit "Shadow" dhe Marrëveshjes për Pjesëmarrje të Pjesëmarrësit të Regjistruar.
10. Ky nen i mbijeton ndërprerjes së Marrëveshjes për Pjesëmarrje të Pjesëmarrësit të Regjistruar.

Neni 55

Pezullimi i Marrëveshjes për Pjesëmarrje

1. Platforma e Alokimit mund të pezullojë përkohësisht të drejtat e Pjesëmarrësit të Regjistruar në lidhje me këto Rregulla të Alokimit "Shadow" me një njoftim të menjëhershëm nëse Pjesëmarrësi i Regjistruar bënë një shkelje të madhe të detyrimit në lidhje me këto Rregulla të Alokimit "Shadow", e cila mund të ketë ndikimet e konsiderueshme në Platformën e Alokimit si më poshtë:
 - (a) nëse pjesëmarrësi i regjistruar nuk arrin të paguajë ndonjë shumë të papaguar dhe mbetet në detyrim të platformës për alokim në përputhje me nenin 51;
 - (b) nëse pjesëmarrësi i regjistruar dështon të sigurojë dhe të mbajë kolateralet në përputhje me nenin 23;
 - (c) çfarëdo shkelje që mund të ketë ndikim të konsiderueshëm financiar në Platformën e Alokimit;
 - (d) Platforma e Alokimit ka arsye të besoj se Pjesëmarrësi i Regjistruar më nuk plotëson një ose më shumë nga kushtet e tjera për të marrë pjesë në ankandet "Shadow" sipas këtyre Rregullave të Alokimit, përveçse kur ndërprerja vlen sipas nenit 56; dhe
 - (e) nëse Pjesëmarrësi i Regjistruar është në sanksione ekonomike dhe tregtare të cilat mund të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi platformën e alokimit.
2. Në rast të një shkeljeje të vogël në lidhje me këto Rregulla të Alokimit Shadow, të tilla si, por pa kufizim, në dështimin e Pjesëmarrësit të Regjistruar që të njoftoj për ndryshimin në informacionin e paraqitur në përputhje me nenin 8, Platforma e Alokimit mundet që përmes njoftimit për Pjesëmarrësin e Regjistruar të informoj të njëjtin që të drejtat e tij në lidhje me këto Rregulla të Alokimit "Shadow" mund të pezullohen, përveç rastit kur pjesëmarrësi i regjistruar korrigjon gjendjen brenda periudhës kohore të specifikuar në njoftim. Pezullimi do të hyjë në fuqi kur të ketë kaluar periudha e specifikuar për korrigjim, por pa bërjen e një korrigjimi

të tillë. Pas hyrjes në fuqi të pezullimit në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, pjesëmarrësi i regjistruar i pezulluar nuk mund të marrë më pjesë në një ankand "Shadow".

3. Platforma e Alokimit mund të tërheqë njoftimin sipas paragrafëve 1 ose 2 të këtij neni në çdo kohë. Pasi ka dhënë njoftimin sipas paragrafëve 1 ose 2 të këtij neni, Platforma e Alokimit mund të bëjë një njoftim të mëtejshëm ose njoftim tjetër në çdo kohë në lidhje me të njëjtën ose një ngjarje tjetër pezullimi.
4. Pasi pjesëmarrësi i regjistruar të ketë përmbushur ose korrigjuar ngjarjen e pezullimit siç i është njoftuar në njoftimin e dërguar nga Platforma e Alokimit, Platforma e Alokimit do të rivendosë sa më shpejt të jetë e mundur të drejtat e pjesëmarrësit të regjistruar në lidhje me aftësinë e tij për të marrë pjesë në ankandet "Shadow" me njoftim me shkrim për pjesëmarrësin e regjistruar. Që nga data e hyrjes në fuqi të rikthimit, pjesëmarrësi i regjistruar mund të marrë pjesë në ankandet Shadow.
5. Nëse Platforma e Alokimit i dërgon njoftimin një pjesëmarrësi të regjistruar sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni, njoftimi i tillë i pezullimit nuk e liron Pjesëmarrësin e Regjistruar nga detyrimet e tij të pagesës sipas KAPITULLIT 8, duke përfshirë detyrimet e tij të pagesës në lidhje me të Drejtat e Transmetimit për të cilën pjesëmarrësi i regjistruar humb të drejtën e përdorimit sipas paragrafit 2.

Neni 56

Ndërprerja e Marrëveshjes për Pjesëmarrje

1. Një pjesëmarrës i regjistruar në çdo kohë mund t'i kërkojë Platformës së Alokimit të ndërpresë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në të cilën Pjesëmarrësi i Regjistruar është Palë. Ndërprerja do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë pune pas marrjes së kërkesës për ndërprerje nga Platforma e Alokimit dhe nëse të gjitha detyrimet e papaguara janë shlyer.
2. Pjesëmarrësi i Regjistruar mund të përfundojë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në të cilën Pjesëmarrësi i Regjistruar është Palë për arsye të bazuar kur Platforma e Alokimit ka bërë shkelje të madhe të një detyrimi që lidhet me këto Rregulla të Alokimit "Shadow" ose Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në rastet e mëposhtme:
 - (a) kur Platforma e Alokimit në mënyrë të përsëritur dështon të paguajë ndonjë shumë të papaguar dhe që i detyrohet Pjesëmarrësit të Regjistruar me një ndikim të konsiderueshëm financiar;
 - (b) kur ka shkelje të konsiderueshme të detyrimeve të konfidencialitetit në përputhje me nenin 59.

Pjesëmarrësi i regjistruar do të dërgojë njoftimin për Platformën e Alokimit që tregon arsyen e ndërprerjes dhe i jep Platformës së Alokimit njëzet (20) ditë pune për të korrigjuar shkeljen. Përveç nëse Platforma e Alokimit korrigjon shkeljen brenda afatit të lartpërmendur, ndërprerja do të hyjë në fuqi menjëherë pas skadimit të këtij afati.

3. Nëse ndodh ndonjë ngjarje e ndërprerjes sipas paragrafit 4 në lidhje me një pjesëmarrës të regjistruar, Platforma e Alokimit përmes njoftimit për Pjesëmarrësin e Regjistruar mund të ndërpresë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes, përfshirë të drejtat e Pjesëmarrësit të Regjistruar lidhur me Rregullat e Alokimit "Shadow". Ndërprerja sipas këtij paragrafi hyn në fuqi nga momenti i njoftimit ose në çfarëdo kohe të mëvonshme të specifikuar në njoftim. Pjesëmarrësi i regjistruar nuk mund të hyjë më në Marrëveshjen për Pjesëmarrje me Platformën e Alokimit në një fazë të mëvonshme derisa rrethanat e ndërprerjes të vazhdojnë të ekzistojnë ose nuk

garantohet mjaftueshëm se shkelja nuk do të ndodhë më.

4. Ngjarjet e ndërprerjes të përmendura në paragrafin 3 do të jenë si më poshtë:
 - (a) Nëse të drejtat e pjesëmarrësit të regjistruar pezullohen për më gjatë se tridhjetë (30) ditë pune;
 - (b) Nëse një pjesëmarrës i regjistruar nuk kualifikohet për pjesëmarrje në një ankand "Shadow" siç përcaktohet në nenin 9;
 - (c) Nëse një Pjesëmarrës i Regjistruar shkel në mënyrë të përsëritur këto Rregulla të Alokimit "Shadow" ose një marrëveshje pjesëmarrjeje, pavarësisht nëse shkelja mund të korrigjohet apo jo;
 - (d) Nëse një autoritet kompetent (i) përcakton që Pjesëmarrësi i Regjistruar ka bërë një keqpërdorim ose akt mashtrues dhe (ii) kërkon nga Platforma e Alokimit të përfundojë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në të cilën pjesëmarrësi i regjistruar është Palë ose (iii) pajtohet se Platforma e Alokimit ka arsye të bazuara për të besuar se Pjesëmarrësi i Regjistruar ka bërë keqpërdorim ose veprim mashtrues gjatë pjesëmarrjes në ankande; ose
 - (e) Nëse Pjesëmarrësi i Regjistruar ka ndërmarrë çfarëdo veprimi që mund të çojë në dëmtimin ose zvogëlimin e efektivitetit të Mjetit të Ankandit (duke kuptuar që një veprim i tillë konsiderohet të ndodhë në rast të ndonjë sjelljeje që mund të përfshij një sulm ndaj sistemit të informacionit, sikurse por pa u kufizuar në, mohim të shërbimit, spam (mesazhet e padëshiruara), virus, sulmet me forcë, sulmi me "Trojan Horse").
5. Pasi ndërprerja të hyj në fuqi në përputhje me paragrafët 1 deri në 3 të këtij neni dhe që nga ajo kohë, pjesëmarrësi i regjistruar nuk mund të marrë më pjesë në një ankand "Shadow". KAPITULLI 5 nuk do të zbatohet për këto të drejta të fituara të transmetimit. Për heqje të dyshimit, të Drejtat e Transmetimit, të cilat Pjesëmarrësit e Regjistruar e kanë të ndaluar t'i përdorin për shkak të ndërprerjes, mund të ofrohen nga Platforma e Alokimit në ankandet e mëvonshme.
6. Ndërprerja e Marrëveshjes për Pjesëmarrje nuk ndikon në asnjë të drejtë dhe detyrim sipas ose në lidhje me Marrëveshjen për Pjesëmarrjes dhe Rregullat e Alokimit Shadow të cilat janë iniciuar para ndërprerjes të asaj marrëveshjeje, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë nen. Rrjedhimisht, çdo pjesëmarrës i regjistruar, marrëveshja e pjesëmarrjes e të cilit ndërpritet, do të mbetet përgjegjës në përputhje me Rregullat e Alokimit Shadow për të gjitha këto të drejta dhe detyrime. Ky paragraf do të zbatohet pa cenuar mjetet e tjera juridike të disponueshme për Platformën e Alokimit sipas këtyre Rregullave të Shpërndarjes Shadow

Neni 57

Forca Madhore

1. Platforma e Alokimit ose një pjesëmarrës i regjistruar, i cili thirret në Forcën Madhore, do t'i dërgojë menjëherë Palës tjetër një njoftim që përshkruan natyrën e forcës madhore dhe kohëzgjatjen e mundshme të saj dhe do të vazhdojë të japë raporte në lidhje me të me shpeshtësi të arsyeshme gjatë periudhës së kohëzgjatjes të forcës madhore. Pala që thirret në forcën madhore do të bëjë çdo përpjekje të mundshme për të kufizuar pasojat e forcës madhore.
2. Obligimet, detyrat dhe të drejtat e prekura të një Pale që i nënshtrohet Forcës Madhore do të pezullohen që nga fillimi i Forcës Madhore, me përjashtim të dispozitave të konfidencialitetit

në përputhje me nenin 59.

3. Pezullimi sipas paragrafit 2 i nënshtrohet sa vijon:
 - (a) Pezullimi nuk do të ketë një shtrirje më të madhe dhe nuk do zgjas më shumë se sa kërkohet nga Forca Madhore;
 - (b) Pezullimi zbatohet vetëm për atë kohë sa Pala që i referohet Forcës Madhore bënë përpjekje të arsyeshme për të korrigjuar paaftësinë e saj për performim.
4. Pasojat e një ngjarje të Forcës Madhore, që nuk i nënshtrohet diskutimit apo konfliktit midis Platformës së Alokimit dhe Pjesëmarrësit të Regjistruar, janë:
 - (a) Pala që thirret në Forcën Madhore nuk mund të mbahet përgjegjëse për të paguar dëmshpërblimin për çfarëdo dëmi të pësuar, për shkak të mospërmbushjes ose përmbushjes së pjesshme të të gjitha ose ndonjë prej detyrimeve të saj gjatë Forcës Madhore dhe kur kjo mospërmbushje ose përmbushje e pjesshme është për shkak të Forcës Madhore;
 - (b) Të drejtat ditore të transmetimit, të cilat janë paguar tërësisht dhe i nënshtrohen Forcës Madhore, rimbursohen për kohëzgjatjen e Forcës Madhore në përputhje me çfarëdo legjislacioni në fuqi dhe këto Rregulla të Alokimit “Shadow”; dhe
5. Nëse Forca Madhore vazhdon për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj, Platforma e Alokimit ose çdo Pjesëmarrësi i Regjistruar, duke e njoftuar tjetrin kurdo përderisa Forca Madhore vazhdon përtej asaj periudhe, mundet të ndërpresë në mënyrë të njëanshme Marrëveshjen e Pjesëmarrjes. Ndërprerja do të hyjë në fuqi dhjetë (10) ditë pune pas dhënies së njoftimit ose ndonjë date të mëvonshme të specifikuar në njoftim.
6. Që të shmanget dyshimi, ky nen nuk cenon dispozitat e KAPITULLIT 7 në lidhje me shkurtimin e të Drejtave Ditore të Transmetimit.

Neni 58

Njoftimet

1. Çfarëdo njoftimi ose komunikimi tjetër që do të jepet sipas ose në lidhje me këto Rregulla të Alokimit “Shadow” do të jetë në gjuhën angleze.
2. Përveç nëse shprehimisht parashikohet ndryshe në këto Rregulla të Alokimit “Shadow”, të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera ndërmjet Platformës së Alokimit dhe secilit Pjesëmarrës të Regjistruar do të bëhen me shkrim dhe do të dërgohen me mjete elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit dhe do të shënohen për vëmendjen e përfaqësuesit të palës tjetër, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes ose siç njoftohet herë pas here nga pjesëmarrësi i regjistruar në përputhje me nenin 8.
3. Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera do të bëhen me letër të dorëzuar në dorë kundrejt marrjes së vërtetimit për dërgim ose dërgohen me postë të rekomanduar ose korrier në rastet e mëposhtme:
 - (a) përfundimi i Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në përputhje me nenin 6;
 - (b) pezullimi dhe përfundimi sipas nenit 55 dhe nenit 56; dhe
 - (c) paraqitjen e Garancisë Bankare, në rast se Garancia Bankare përfshin nënshkrimin(-et) me dorë, në përputhje me nenin 19.

4. Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera do të konsiderohen se janë marrë:
 - (a) në rastin e dorëzimit në dorë, kur dorëzohet dhe merret fletëvërtetimi i dërgimit; ose
 - (b) në rastin e dërgesës me postë të regjistruar me parapagesë në ditën pas ditës së regjistruar të dorëzimit; ose
 - (c) në rastin e njoftimeve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit, kur i dorëzohen palës tjetër, por vetëm nëse kërkohet dhe merret një konfirmim marrjeje nga pala që dërgon njoftimin elektronik siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit.
5. Nëse një njoftim ose komunikim tjetër është marrë jashtë orarit normal të punës në një ditë pune, ai konsiderohet të jetë marrë në ditën tjetër të punës.

Konfidencialiteti

1. Marrëveshja e Pjesëmarrjes dhe çfarëdo informacioni tjetër i shkëmbyer në lidhje me përgatitjen e tij dhe aplikimin e një pjesëmarrësi të tregut do të konsiderohen si konfidenciale.
2. Duke ju nënshtruar paragrafit 3 të këtij neni, Platforma e Alokimit dhe çdo Pjesëmarrës i Regjistruar që është marrës i informacionit konfidencial në lidhje me këto Rregulla të Alokimit Shadow do të ruajnë konfidencialitetin e këtij informacioni dhe nuk do të zbulojnë, raportojnë, publikojnë, transferojnë ose përdorin drejtpërdrejt ose tërthorazi çfarëdo artikulli të informacionit konfidencial, përveçse për qëllimin për të cilin është zbuluar.
3. Pavarësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, Platforma e Alokimit ose një Pjesëmarrës i Regjistruar mund të zbulojë informacionin konfidencial tek një Palë e tretë me pëlqimin paraprak të palës tjetër të shprehur me shkrim dhe me kusht që pala marrëse të ketë dhënë siguri se kjo palë e tretë ka detyrime ekuivalente të ruajtjes së konfidencialitetit siç përcaktohen në këto Rregulla të Alokimit Shadow të zbatueshme drejtpërdrejt nga Pala tjetër.
4. Pavarësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, Platforma e Alokimit ose një Pjesëmarrës i Regjistruar mund të zbulojë informacionin konfidencial të një Pale:
 - (a) në masën që lejohet ose parashikohet shprehimisht nga Rregullat e Alokimit Shadow;
 - (b) për çdo person që është një nga drejtorët, zyrtarët, punonjësit, agjentët, këshilltarët ose siguruesit e marrësit dhe që ka nevojë të dijë informacionin konfidencial në lidhje me këto Rregulla të Alokimit Shadow;
 - (c) për aq sa kërkohet në mënyrë që të ketë pajtueshmëri me legjislacionin e BE-së (si Rregullorja (BE) Nr. 1227/2011 dhe Rregullorja (BE) Nr. 543/2013) ose aktet ligjore në fuqi të Komunitetit të Energjisë, dhe/ose legjislacionin kombëtar në fuqi ose ndonjë tjetër akt përkatës administrativ vendor si kodet e rrjetit;
 - (d) përderisa kërkohet nga një gjykatë, arbitër ose tribunal administrativ ose një ekspert i procedurave para të cilave pranuesi është palë;
 - (e) siç mund të kërkohet nga Operatorët përkatës të Sistemit të Transmetimit për përmbushjen e duhur të misionit të tyre dhe detyrimeve të tyre në përputhje me ligjet në fuqi dhe këto Rregulla të Alokimit Shadow nga vetë ata ose përmes agjentëve ose këshilltarëve; ose
 - (f) për aq sa kërkohet për të marrë leje ose pëlqime nga një autoritet kompetent.
5. Për më tepër, detyrimet që rrjedhin nga ky nen nuk zbatohen:
 - (a) Nëse Pala që merr informacionin mund të dëshmojë se në kohën e zbulimit (të informacionit), ky informacion ishte tashmë i disponueshëm publikisht;
 - (b) Nëse Pala që merr informacionin ofron dëshmi se që nga koha e zbulimit, informacioni në fjalë është marrë ligjërisht nga një palë e tretë ose është bërë i disponueshëm publikisht;
 - (c) Për informacionin konfidencial të komunikuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullative, në një formë të inkuorporuar nga e cila nuk mund të nxirret asnjë informacion specifik për një pjesëmarrës në treg;

- (d) për informacionin publikimi i të cilit parashikohet në mënyrë eksplicite nga Rregullat aktuale të Alokimit Shadow.
6. Detyrimet e konfidencialitetit në këtë nen do të mbeten të vlefshme për një periudhë prej pesë (5) vitesh pas përfundimit të Marrëveshjes për Pjesëmarrje të Pjesëmarrësit të Regjistruar.
 7. Nënshkrimi i Marrëveshjes për Pjesëmarrje dhe shkëmbimi i informacionit konfidencial nuk japin asnjë të drejtë mbi patentat, njohuritë ose ndonjë formë tjetër të pronësisë intelektuale në lidhje me informacionin ose mjetet e vëna në dispozicion ose të dërguara nga njëra palë te tjetra sipas kushteve të këtyre Rregullave të Alokimit Shadow.

Neni 60

Caktimi dhe nënkontraktimi

1. Platforma e Alokimit mund të caktojë, zëvendësoj ose transferojë në një platformë tjetër të alokimit ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e saj sipas Marrëveshjes për Pjesëmarrje ose këtyre Rregullave të Alokimit Shadow. Platforma e alokimit do të njoftojë pjesëmarrësit e regjistruar për ndryshimin duke dërguar njoftimin elektronik siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit me konfirmim të marrjes të të njëjtit sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast të paktën dhjetë (10) ditë pune përpara datës në të cilën ndryshimi hyn në fuqi.
2. Një pjesëmarrës i regjistruar nuk mund të caktojë, zëvendësoj ose përndryshe të transferojë asnjë nga të drejtat ose detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së tij të Pjesëmarrjes ose këtyre Rregullave të Alokimit Shadow pa pëlqimin paraprak me shkrim të Platformës së Alokimit.
3. Asgjë në këtë nen nuk do të parandalojë platformën e alokimit ose pjesëmarrësin e regjistruar që të hyjë në një marrëveshje nënkontraktimi në lidhje me këto Rregulla të Alokimit Shadow. Hyrja në një marrëveshje nënkontraktimi nga një pjesëmarrës i regjistruar nuk e liron Pjesëmarrësin e regjistruar nga asnjë detyrim ose përgjegjësi sipas Marrëveshjes së tij të Pjesëmarrjes ose këtyre Rregullave të Shpërndarjes Shadow.

Neni 61

Ligji qeverisës

Këto Rregulla të Alokimit Shadow do të zbatohen si dhe do të interpretohen në përputhje me **Ligjin belg** në të gjitha aspektet.

Neni 62

Gjuha

Gjuha e zbatueshme për këto Rregulla të Alokimit Shadow do të jetë gjuha angleze. Për shmangie të dyshimit, kur Operatorët e Sistemit të Transmetimit i përkthejnë këto Rregulla të Alokimit Shadow në gjuhën e tyre kombëtare, në rast të mospërputhjes midis versionit në gjuhën angleze të publikuar nga Platforma e Alokimit dhe çfarëdo versionit në një gjuhë tjetër, versioni në gjuhën angleze i publikuar nga Platforma e Alokimit do të mbizotërojë.

Neni 63

Pronësia intelektuale

Asnjë Palë nuk do të fitojë ndonjë të drejtë, titull, licencë ose interes ndaj ndonjë të drejte të pronësisë intelektuale të Palës tjetër në lidhje me këto Rregulla të Alokimit Shadow.

Neni 64

Marrëdhëniet e Palëve

1. Marrëdhënia mes Platformës së Alokimit dhe Pjesëmarrësit të Regjistruar është një marrëdhënie e ofruesit të shërbimit dhe përdoruesit të shërbimit. Me përjashtim të rasteve të parashikuara shprehimisht në këto Rregulla të Alokimit Shadow, asgjë që këto Rregulla të Alokimit përmbajnë nuk do përbëjë ose të konsiderohet se përbën platformën e alokimit ose një pjesëmarrës të regjistruar, partnerin, agjentin ose përfaqësuesin ligjor të tjetrit për çfarëdo qëllimi ose të krijojnë apo të konsiderohet se krijojnë ndonjë partneritet, agjenci ose besim midis Palëve.
2. Pjesëmarrësi i regjistruar e pranon se as Platforma e Alokimit dhe as ndonjë person që vepron në emër ose lidhur me Platformën e Alokimit nuk bën ndonjë përfaqësim, nuk jep ndonjë këshillë, garanci ose të kuptuar të çfarëdo lloji në lidhje me këto Rregulla të Alokimit Shadow, Marrëveshjet e Pjesëmarrjes ose informacionin e zbuluar ose që përndryshe ndërlidhet me këto Rregulla të Alokimit Shadow, Marrëveshjet e Pjesëmarrjes dhe informacionin e shpalosur ose çfarëdo transaksioni apo marrëveshje të parashikuar nga këto Rregulla të Alokimit Shadow, Marrëveshjet e Pjesëmarrjes dhe informacionet e shpalosura, përveç siç parashikohet në mënyrë specifike në këto Rregulla ose në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes.

Neni 65

Nuk ka të drejta të palëve të treta

Platforma e Alokimit dhe çdo pjesëmarrës i regjistruar pranon dhe pajtohet që një person që nuk është palë në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes ndërmjet tyre, përfshirë çdo pjesëmarrës tjetër të tregut, nuk ka të drejtë të zbatojë këto Rregulla të Alokimit Shadow ose Marrëveshjen e Pjesëmarrjes ndërmjet Platformës së Alokimit dhe atij Pjesëmarrësi të Regjistruar.

Neni 66

Heqja dorë

1. Mos ushtrimi apo vonesa në ushtrimin e çfarëdo të drejte, kompetence ose mjeti juridik të parashikuar me ligj ose në bazë të këtyre Rregullave të Alokimit nuk do të cenoj apo nuk do të përbëjë heqje dorë nga kjo ose ndonjë e drejtë, kompetence ose mjet tjetër juridik. Ushtrimi i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte, kompetence ose mjeti juridik të tillë nuk përjashton ose cenon ushtrimin e mëtejshëm të tij ose ushtrimin e ndonjë të drejte, kompetence apo mjeti tjetër juridik të parashikuar me ligj ose në bazë të këtyre Rregullave të Alokimit Shadow.
2. Çfarëdo heqje dorë nga ndonjë e drejtë, kompetencë ose mjeti juridik sipas këtyre Rregullave të Alokimit Shadow duhet të bëhet me shkrim dhe mund të jepet varësisht nga kushtet që mendohen si të përshtatshme nga dhënësi. Përveç nëse shprehimisht përcaktohet ndryshe, çdo heqje dorë është efektive vetëm për rastin dhe qëllimin për të cilin është dhënë.

Neni 67

Marrëveshja e plotë

Këto Rregulla për Alokimin "Shadow" dhe Marrëveshja e Pjesëmarrjes përmbajnë ose i referohen shprehimisht të gjithë marrëveshjes mes Platformës së Alokimit dhe secilit Pjesëmarrës të Regjistruar në lidhje me lëndën dhe përjashton shprehimisht çfarëdo garancie, kushti ose veprimi tjetër të nënkuptuar me ligj dhe shfuqizon të gjitha marrëveshjet dhe mirëkuptimet e mëparshme mes platformës së alokimit dhe çdo pjesëmarrësi të regjistruar. Platforma e Alokimit dhe çdo pjesëmarrës i regjistruar pranojnë dhe konfirmojnë se asnjëri prej tyre nuk aderon në këto Rregulla të Alokimit Shadow ose Marrëveshjen e Pjesëmarrjes duke u mbështetur në ndonjë përfaqësim,

garanci ose veprim tjetër (përveç rasteve kur është bërë me mashtrim) që nuk pasqyrohet plotësisht në kushtet e këtyre Rregullave të alokimit “Shadow” ose në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes.

Neni 68

Mjetet juridike ekskluzive

Të drejtat dhe mjetet juridike të parapara nga këto Rregulla të Alokimit Shadow dhe Marrëveshja e Pjesëmarrjes për Platformën e Alokimit dhe për secilin Pjesëmarrës të Regjistruar janë ekskluzive dhe jo kumulative dhe, në masën e lejuar me ligj, do të përjashtojnë dhe zëvendësojnë të gjitha të drejtat ose mjetet juridike thelbësore (por jo procedurale) të shprehura ose të nënkuptuara dhe të parapara me ligj ose statut në lidhje me objektin e këtyre Rregullave të Alokimit Shadow dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes. Rrjedhimisht, Platforma e Alokimit dhe çdo Pjesëmarrës i Regjistruar heq dorë në masën më të plotë të mundshme nga të gjitha këto të drejta dhe mjete juridike të parapara me ligj ose statut, dhe e lirojnë njëri-tjetrin, nëse janë përgjegjës ndaj ndonjë prej tyre, si dhe zyrtarët, punonjësit dhe agjentëve të tyre të njëjtën masë nga të gjitha detyrat, detyrimet, përgjegjësitë apo obligimet e parapara me ligj apo statut sa i përket çështjeve të trajtuara në këto Rregulla të Alokimit "Shadow" dhe Marrëveshja për Pjesëmarrje si dhe zotohen të mos zbatojnë asnjë prej tyre përveç nëse është paraparë shprehimisht këtu.

Neni 69

Vlefshmëria e pjesshme (severabiliteti)

Nëse ndonjë dispozitë e këtyre Rregullave të Alokimit Shadow ose të Marrëveshjes për Pjesëmarrje është shpallur e pavlefshme, e pazbatueshme ose e paligjshme nga gjykatat e çfarëdo juridiksioni të cilit i nënshtrohet, apo në bazë të arbitrazhit ose me urdhër të ndonjë autoriteti kompetent, një pavlefshmëri, pazbatueshmëri ose paligjshmëri e tillë nuk do të cenoj ose ndikojë dispozitat e tjera të këtyre Rregullave të Alokimit Shadow dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, të cilat do të vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë, pavarësisht nga pavlefshmëria, pazbatueshmëria ose paligjshmëria e tillë. Çdo pjesë ose dispozitë e pavlefshme, e paligjshme, dhe/ose e pazbatueshme do të zëvendësohet me pjesë ose dispozita të vlefshme, ligjore dhe/ose të zbatueshme në mënyrë që të arrihet efekti i synuar ekonomik dhe juridik.

Shtojca 1

Lista e kufijve të Zonës së Ofertimit për të cilat zbatohen Rregullat e Alokimit Shadow

Lista e kufijve të Zonës së Ofertimit		
Lista e OST-ve përgjegjëse		
Shqipëria (AL)	<>	Kosova (XK)
OST		KOSTT

Kjo listë e kufijve të zonës së ofertimit për të cilat zbatohen Rregullat e Alokimit Shadow mund të ndryshohet ose plotësohet në përputhje me dispozitat e Nenit 52 (Kohëzgjatja dhe ndryshimi i Rregullave të Alokimit Shadow) të këtyre Rregullave të Alokimit Shadow.